


Libri i Allahut
dhe
Pozita e tij Madhështore



Shejkh 'Abdul-'Azizj Ali-Shejkh

SELEFI
Kurani dhe Suneti
sipas kuptimit të Salefëve të këtij Umeti







❁ Disa fjalë rreth Autorit	fq. 4
❁ Hyrje	fq. 6
❁ Kuptimi i fjalës Kur'an	fq. 10
❁ Mrekullitë dalluese të Kur'anit	fq. 20
❁ Vlera e recitimit të Kur'anit	fq. 24
❁ Poseduesi i Kur'anit do të ketë gradat më të larta Ditën e Kijametit	fq. 26
❁ Vlera e mësimi të Kur'anit përmendësh	fq. 30
❁ Pjesa e obligueshme për ta mësuar përmendësh nga Kur'ani	fq. 32
❁ Çështje të cilat duhen patur parasysh nga ai që do ta recitojë Kur'anin dhe ta mësojë përmendësh	fq. 33
❁ Edukata e lexuesit të Kur'anit	fq. 49



Ai është dijetari i nderuar, 'Abdul-'Azizj Ibn 'Abdullah Ibn Muhamed Ibn Ibrahim Aali-Shejkh. Ka lindur në Rijad në vitin 1362 Hixhrij/1941 E.K. Që kur ka lindur, ai ka vuajtur nga shikimi i dobët i syve, derisa e humbi shikimin plotësisht më 1381 Hixhrij/1960 E.K.

Ai nisi të kërkojë dije duke studiuar fillimisht Kur'anin Fisnik në Xhaminë Ahmed Sanan, duke e mësuar përmendësh kur ishte 12 vjeç.

Më pas, ai kërkoj dije nga disa prej dijetarëve duke u ulur në mexhlistet e tyre. Më 1375 Hixhrij/1954 E.K, ai transferohet në Institutin *Imam ed-Da'ueh*, ku u diplomua në Fakultetin e Sheriatit më 1383 Hixhrij/1962 E.K. Atje ai merrte pjesë në mexhlistet e disa prej dijetarëve në xhamitë e tyre.

E filloi aktivitetin e tij fetar pas diplomimit në Fakultetin e Sheriatit, më 1383Hixhrij/1962 E.K, e më pas punoi si mësues në Institutin *Imam ed-Da'ueh el-Ilmij*, deri më 1392 Hixhrij/1971 E.K. Më pas u transferua për të dhënë mësim në Fakultetin e Sheriatit (Universiteti Imam Muhamed), në Rijad. Vazhdoi të jepte mësim atje deri në vitin 1412 Hixhrij/1991 E.K.

Më pas, ai u bë anëtar i Këshillit të Dijetarëve të Mëdhenj, më 1407 Hixhrij/1986 E.K. Dhe më pas u bë anëtar i Komisionit të Përhershëm për Hulumtime fetare dhe Fetva, ku u caktua zëvendësi i myftiut të madh të Mbretërisë (Shejkh 'Abdul-'Azizj Ibn Baz, *rahimehullab*), më 1416 Hixhrij/1995 E.K.

Ai ishte Imami i namazit të Xhumasë në Xhaminë e Shejkh 'Abdullah Ibn

'Abdul-Latijf, deri më 1390 Hixhrij/1969 E.K. Më vonë u transferua në detyrën e imamit në Xhaminë Qendrore të el-Imam Turki Ibn 'Abdullah, si dhe khatib në Xhaminë Nemira në ditën e Arafatit më 1402 Hixhrij/1981 E.K, detyrë të cilën e kryen deri më sot.

Gjatë kohës që ka qenë në Fakultetin e Sheriatit, ai i mbikqyrte disa nga temat e magistraturës dhe të doktoraturës në Universitet dhe merrte pjesë në këto diskutime.

Që nga viti 1414 Hixhrij/1993 E.K, ai ka marrë pjesë në programin radiofonik "*Nurun 'ala-Derb*", duke iu përgjigjur pyetjeve që i parashtroheshin nga dëgjuesit.

Gjithashtu, ai ka dhënë mësim në Xhaminë Qendrore të el-Imam Turki Ibn Abdullah. Ai merr pjesë në seminare dhe leksione, përveç punës dhe aktivitetit të tij në fushën e daveit në Rijad dhe në Taif.

Aktualisht Shejkh 'Abdul'Azijz bin 'Abdullah Ali-Shejkh është Myftiu i madh i Arabisë Saudite, Kryetar i Komisionit të Dijetarëve të mëdhenj dhe Kryetar i Komisionit të Përhershëm për Hulumtime dhe Fetva.





E gjithë lavdia i takon Allahut, Ai i Cili i zbriti rob-it të Tij Librin dhe nuk la në të asnjë shtrembërim.

Ai e ka bërë atë shembull të drejtë për të paralajmëruar rreth Dënimit të dhimbshëm prej Tij; dhe për të përgëzuar besimtarët që bëjnë vepra të mira se për ta do të ketë një shpërblim të mrekullueshëm (Xhennetin), në të cilin do të banojnë përjetësisht.

Dhe për t'i paralajmëruar ata që thonë: "Allahu ka lindur djalë."

E gjithë lavdia i takon Allahut, Ai i Cili zbriti *Furkanin* (Kur'anin, i cili është kriteri ndarës i të vërtetës nga e pavërteta) mbi robin e Tij, për të paralajmëruar krejt njerëzimin.

Lavdërimi dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Pejgamberin tonë Muhamed; i Dërguari me udhëzim dhe mëshirë, përgëzues dhe paralajmërues; thirrës për tek Allahu me lejen e Tij dhe llampë ndriçuese, lavdërimi i Allahut qoftë mbi të si dhe mbi Familjen e tij, Shokët e tij dhe mbi atë që ecën në rrugën e tij dhe ndjek Sunetin e tij deri në Ditën e Gjykimit.

E më pas:

Me të vërtetë Allahu i Lartësuar u ka dhënë mirësi të madhe krijesave të Tij, veçanërisht robërve të Tij besimtarë, duke u çuar të Dërguarin e Tij fisnik (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), dhe me të zbriti më të mirin nga Librat e tij dhe vulën e tyre - Kur'anin – i cili është Dëshmues për të gjithë ata.

Allahu *'Azze ue Xhel* thotë:



لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْ أَنفُسِهِمْ يَتْلُوا عَلَيْهِمْ ءَايَاتِهِ
وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِن كَانُوا مِن قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿١٦٤﴾

“Me të vërtetë, Allahu derdhi mbi njerëzimin mirësi të madhe, veçanërisht mbi besimtarët, duke u çuar një të Dërguar fisnik nga mesi i tyre, duke iu lexuar atyre Vargjet e Tij, duke i pastruar ata dhe duke u mësuar atyre Librin dhe Urtësinë (Sunnëtin Pejgamberik), edhe pse para kësaj ata kanë qenë në devijim të qartë.”¹

Dhe në Sahihun e Imam Muslimit, nga transmetimi i 'Ijad bin Himar el-Muxhashi'ij (*radij-Allahu 'anhu*): se një ditë i Dërguari i Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) tha në një nga hytbet e tij:

«ألا إن ربي أمرني أن أعلمكم ما جهلتم مما علمني يومي هذا ، كل مال نحلته عبدا حلال ، وإنني خلقت عبادي حنفاء كلهم ، وإنهم أتتهم الشياطين فاجتالتهن عن دينهم ، وحرمت عليهم ما أحللت لهم ، وأمرتهم أن يشركوا بي ما لم أنزل به سلطانا ، وإن الله نظر إلى أهل الأرض فمقتهم ، عربهم وعجمهم ، إلا بقايا من أهل الكتاب ، وقال : إنما بعثتك لأبتيك وأبتي بك ، وأنزلت عليك كتابا لا يغسله الماء ، تقرؤه نائما ويقظان »

“Me të vërtetë Zotit im më urdhëroi t’ju mësoj atë që ju nuk e dini. Nga ajo që Ai më mësoi këtë ditë sot është: “**Robërit e Mi e kanë të lejuar pasurinë që u jap. Unë i krijova të gjithë robërit e Mi në fenë e vërtetë (Hanefijeh),² por**

¹ Aali-Imran, 164.

² **Shënim i përkthyesit:** Ka thënë Shejkhul-Islam Muhamed Ibn 'Abdul-Uehab (rahimehullah) në broshurën e tij “*el-Kaua'idul-Erba'a*”: “Dije, Allahu të udhëzoftë në bindjen ndaj Tij, se Hanifijeh është feja e Ibrahimit: Ajo është që ti ta adhurosh Allahun duke e bërë fenë të pastër për Të, sikurse Ai thotë: “**Dhe Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit përveç që ata të më adhurojnë Mua (të Vetëm).**” [edh-Dharijjat, 56]”

Shejkh Salih el-Feuzan në shpjegimin që i ka bërë asaj broshure ka thënë se: “*El-Hanifijeh* është feja e *el-Hanif*, i cili është Ibrahimit. Hanif është ai që e pranon Allahun me zemrën e tij, veprat e tij, njetet dhe qëllimet e tij, duke i bërë këto të gjitha për Allahun dhe e refuzon çdo gjë tjetër veç Tij. Dhe Allahu na ka urdhëruar që ta ndjekim fenë e Ibrahimit:

atyre u erdhën shejtanët dhe i larguan nga feja e tyre, ua ndaluan atë që ua kisha bërë të lejuar dhe i urdhëruan që të më bëjnë shok në adhurim, gjë për të cilën Unë nuk kam dhënë asnjë të drejtë.” Vërtet Allahu i vështroi banorët e tokës dhe i përbufzi ata që të gjithë, Arabë apo jo Arabë, me përjashtim të një pakice nga Ehli-Kitabët dhe tha: “Unë ju dërgova vetëm që t’ju sprovtoj dhe të sprovtoj të tjerët nëpërmjet jush, dhe ju zbrita një Libër, shkronjat e të cilit nuk shpëlahen nga uji,³ që do ta lexoni kur të jeni në gjumë e kur të jeni zgjuar.”⁴”⁵

Dhe ky Libër është Dëshmues i të gjithë Librave të shpallur më parë. Allahu i Lartësuar thotë:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ وَمُهَيْمِنًا عَلَيْهِ

“Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre.”⁶

Dhe kuptimi është se ai ka pozitën më të lartë dhe qëndron përmbi librat e tjerë që janë shpallur para tij. Ai është ruajtësi, gjykuesi, dëshmuesi dhe vlerësuesi i librave të tjerë.

“Dhe Ai nuk ka vënë mbi ju ndonjë mundim në fe; është feja e babait tuaj, Ibrahimit.” [el-Haxh, 78]

Dhe feja e Ibrahimit, el-Hanifijeh, është: “Që ti ta adhurosh Allahun duke e bërë fenë të pastër për Të.” Ai nuk tha vetëm: “Që ti ta adhurosh Allahun” porse ai tha: “duke e bërë fenë të pastër për Të”, që do të thotë se po largohesh nga shirku, sepse kur adhurimi është i përzier me shirk, ai bëhet i pavlerë. Dhe ai nuk konsiderohet adhurim nëqoftëse ai nuk është i pastër nga shirku i madh dhe shirku i vogël.”

³ Shënim i përkthyesit: “*dhe ju zbrita një Libër, shkronjat e të cilit nuk shpëlahen nga uji*” – Ka thënë Neveviu (rahimehullah) në shpjegimin e kësaj pjese të hadithit: “Kuptimi i saj është: ai është i ruajtur në zemra, nuk do të zhduket, por do të mbetet, përkundër kalimit të kohëve.”

⁴ Shënim i përkthyesit: “*...do ta lexoni kur të jeni në gjumë e kur të jeni zgjuar.*” – Ka thënë Neveviu (rahimehullah) në shpjegimin e kësaj pjese: “Kanë thënë Ulematë: Kuptimi i saj është se ai (Kur'ani) është i ruajtur tek ty qoftë kur je në gjumë e qoftë kur je i zgjuar. Dhe është thënë gjithashtu: E lexoni atë me lehtësi.”

⁵ Sahih Muslim (n. 2865) i Imam Ebul-Husejn Muslim Ibnul-Haxhaxh, me verifikim të Muhamed Fu`ad 'Abdul-Bakij, bot. el-Mektebeh el-Islamijeh, Stamboll, Turqi.

⁶ El-Ma'ideh, 48.

Thotë Ibn Xheriri, Allahu e mëshiroftë: “Kur'ani është ruajtës i librave të shpallur para tij, kështu, çdo gjë nga ato libra që përputhet me Kur'anin është e vërtetë; dhe çdo gjë nga ato libra që e kundërshton Kur'anin është e pavërtetë.”

Libri i Allahut ka një pozitë madhështore në zemrën e Muslimanit dhe ai në vetvete është madhështor, fisnik, i nderuar e i lavdishëm.

Në këtë broshurë ne duam të trajtojmë këtë temë duke dhënë udhëzime dhe këshilla, e ndoshta Allahu na bën dobi prej tyre dhe u bën dobi vëllezërve dhe motrave tona që e lexojnë këtë broshurë ose ua përcjellin të tjerëve këto fjalë. Dhe Ai është Dëgjuesi dhe Ai u Përgjigjet lutjeve.

Kështu, unë po filloj duke kërkuar ndihmën e Allahut.





Fjala 'Kur'an' vjen nga folja *kara'a* (që do të thotë, lexoi), *kur'an* (d.m.th. ai që lexohet). Shembull për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿١٨﴾ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا بَيَانَهُ ﴿١٩﴾ فَإِذَا قَرَأَهُ فَاتَّبِعْ قُرْآنَهُ ﴿٢٠﴾ إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُ وَقُرْآنَهُ ﴿٢١﴾

“Me të vërtetë, na takon Ne që t’i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë. Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij! Pastaj, e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë.”⁷

Fjalët që recitohen quhen gjithashtu *Kur'an*, siç gjendet në thënien e Allahut të Lartësuar:

﴿٩٨﴾ فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ ﴿٩٩﴾

“Kur dëshiron të lexosh Kuranin, atëherë kërko mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar.”⁸

Kur'ani është Fjala e Vërtetë e Allahut, fjalët dhe kuptimi i tij janë nga Allahu. Ai ia zbriti atë rob të Tij, Muhamedit të birit të 'Abdullahut (*sal-Lallahu 'alejhi ue sel-lem*) si shpallje.

Ai është shpallur dhe nuk është i krijuar. Allahu thotë:

⁷ El-Kijameh, 17-19.

⁸ En-Nahl, 98.

تَنْزِيلُ الْكِتَابِ مِنَ اللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ ﴿١٠﴾

“Ky Libër është shpallur nga Allahu i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm!”⁹

Dhe thotë i Përsosuri nga çdo e metë:

قُلْ نَزَّلَهُ رُوحُ الْقُدُسِ مِنْ رَبِّكَ

“Thuaj: “Atë e ka zbritur Shpirti i Shenjtërisë nga Zoti yt.”¹⁰

Dhe Ai thotë:

حَمْدٌ تَنْزِيلُ الْكِتَابِ مِنَ اللَّهِ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ ﴿١١﴾

“Hâ, Mîm. Shpallja e këtij Libri është prej Allahut, të Plotfuqishmit dhe të Gjithëdijshtëmit.”¹¹

Dhe Ai thotë:

تَنْزِيلٌ مِّنَ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١٢﴾

“Kjo është Shpallje prej të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëplotit.”¹²

Dhe Ai thotë:

وَقُرْءَانًا فَرَقْنَاهُ لِتَقْرَأَهُ عَلَى النَّاسِ عَلَى مُكْتٍ وَنَزَّلْنَاهُ تَنْزِيلًا ﴿١٣﴾

⁹ Ez-Zumer, 1.

¹⁰ En-Nahl, 102.

¹¹ Gafir, 1-2.

¹² Fussilet, 2.

“Ky është një Kuran të cilin Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t’ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.”¹³

Ajetet me këtë kuptim janë të shumta. Dhe për këtë ka ixhma tek Selefët e Umetit, Allahu i mëshiroftë që të gjithë.¹⁴

Allahu e ka quajtur këtë Libër me emra të shumtë dhe poashtu e ka përkthyer me cilësi të ndryshme në Librin e Tij. Dhe padyshim që kjo tregon nderin dhe madhësinë që ka ky libër.

Ai është [القرآن] *Kur'ani* (libri që lexohet);

[الفرقان] *Furkani* (ai që ndan të vërtetën nga e pavërteta, të drejtën nga e padrejta);

[الكتاب] *el-Kitab* (Libri);

[الهدى] *el-Huda* (Udhëzimi);

[النور] *en-Nur* (Drita);

[الشفاء] *esh-Shifaa* (Shërimi);

[البيان] *el-Bejan* (Sqarimi);

[الموعظة] *el-Meu'idhab* (Këshilla);

[الرحمة] *er-Rahmeh* (Mëshira);

[البصائر] *el-Besair* (ai që përmban dije të thellë);

[البلاغ] *el-Belag* (Mesazhi),

[العربي] *el-'Arabij* (libri i shpallur në gjuhën e kulluar Arabe);

[المبين] *el-Mubiin* (i Qarti);

[الكريم] *el-Kerim* (Fisniku);

[العظيم] *el-'Adhiim* (Madhështori);

[المجيد] *el-Mexhijid* (i Lavdishmi);

[المبارك] *el-Mubarak* (i Bekuari);

[التنزيل] *et-Tenzil* (Shpallja);

[الصراط المستقيم] *es-Siratul-Mustekim* (Rruga e Drejtë);

[الذكر الحكيم] *edh-Dhikrul-Hakiim* (Përkujtuesi i Urtë);

¹³ El-Isra, 106.

¹⁴ **Shënim i përkthyesit:** Ixhmaja është pajtueshmëria e të gjithë dijetarëve të Umetit Islam pas Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) për një dispozitë të caktuar të Sheriatit. Pra, dijetarët e Islamit kanë ixhma se Kur'ani është Fjala e Allahut dhe se nuk është i krijuar. Andaj, kush thotë se Kur'ani është një krijesë e Allahut sikurse krijesat e tjera, ai person ka bërë kufër dhe ka dalë nga Islami.

Ai është [حبل الله] *Hablullah* (Litari i Allahut);
 Ai është [الذكرى] *edh-Dhikra* (Përkujtimi);
 [التذكرة] *et-Tedhkirah* (ai që të përkujton dhe të këshillon);
 [البشرا] *el-Bushra* (Përgëzimi);
 Ai është [المصدق] *el-Musaddik* (Vërtetuesi i Librave që u shpallën para tij);
 Ai është [المهيمن] *el-Muhejminu* (Dëshmuesi i Librave të mëparshëm);
 Dhe ai është [المثاني] *el-Methanij* (Libri që lexohet vazhdimisht).

Në të ka sqarim dhe shpjegim për çdo gjë, ai sqaron gjithçka dhe nuk ka në të ndonjë dyshim apo ndonjë kundërthënie.

Allahu thotë:

قُرْءَانًا عَرَبِيًّا غَيْرَ ذِي عِوَجٍ لَّعَلَّهُمْ يَتَّقُونَ ﴿٣٨﴾

“Ne e kemi shpallur Kuranin në gjuhën arabe dhe pa asnjë kundërthënie, me qëllim që ata të kenë frikë (Allahun e Lartësuar).”¹⁵

Dhe thotë i Përsosuri nga çdo e metë:

تَبَارَكَ الَّذِي نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَى عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا ﴿١٧﴾

“I Lartësuar me Madhështi qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët (e njerëzve dhe të xhinëve).”¹⁶

Dhe thotë i Përsosuri nga çdo e metë:

الْم ﴿١٧﴾ ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ ﴿١٨﴾

¹⁵ Ez-Zumer, 28.

¹⁶ El-Furkan, 1.

“Elif, Lâm, Mîm. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.”¹⁷

Dhe thotë i Përsosuri nga çdo e metë:

قُلْ مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِجِبْرِيلَ فَإِنَّهُ نَزَّلَهُ عَلَى قَلْبِكَ بِإِذْنِ اللَّهِ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ
وَهُدًى وَبُشْرَى لِلْمُؤْمِنِينَ ﴿١٧﴾

“Thuaju (o Muhamed) atyre që janë armiq të Xhebrailit, se ai e ka zbritur Kuranin në zemrën tënde me lejen e Allahut, si vërtetues të librave të shenjtë të mëparshëm dhe si udhëzim e përgëzim për besimtarët.”¹⁸

Dhe thotë Allahu Krenar e i Madhërishëm:

ذَٰلِكَ نَتْلُوهُ عَلَيْكَ مِنَ الْآيَاتِ وَالذِّكْرِ الْحَكِيمِ ﴿٥٨﴾

“Këto që po t’i tregojmë ty (o Muhamed) janë Vargje dhe Këshilla të Urta (nga Kur’ani).”¹⁹

Dhe thotë Allahu Krenar i Madhërishëm:

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءُكُم بُرْهَانٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ نُورًا مُّبِينًا ﴿١٧٤﴾

“O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë bindëse (Muhamedi) nga Zoti juaj dhe ju është zbritur një Dritë e qartë (Kur’ani).”²⁰

Allahu i Madhëruar thotë:

¹⁷ El-Bekareh, 1-2.

¹⁸ El-Bekareh, 97.

¹⁹ Ali-Imran, 58.

²⁰ En-Nisa`, 174.

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَتْكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي الصُّدُورِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ

لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٧﴾

“O njerëz, ju ka ardhur Këshillë (Kur’ani) nga Zoti juaj, Shërim për zemrat tuaja, Udhëzim dhe Mëshirë për besimtarët.”²¹

Dhe thotë i Përsosuri nga çdo e metë:

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ وَيُبَشِّرُ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ

هُمْ أَجْرًا كَبِيرًا ﴿٥٨﴾

“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe i përgëzon besimtarët që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.”²²

Dhe thotë Allahu i Madhërishëm e i Lartësuar:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَى عَبْدِهِ الْكِتَابَ وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا ﴿٥٩﴾ قَيِّمًا لِّيُنذِرَ بَأْسًا

شَدِيدًا مِّن لَّدُنْهُ وَيُبَشِّرَ الْمُؤْمِنِينَ الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا حَسَنًا ﴿٦٠﴾

“Çdo lavd dhe falënderim i përket Allahut, i Cili i shpalli robit të Vet një Libër të dëlirë nga çdo shtrembërim. (Një libër) të drejtë, për të paralajmëruar nëpërmjet tij dënim të ashpër (për jobesimtarët) dhe për të përgëzuar besimtarë të cilët bëjnë vepra të mira, se për ta do të ketë një shpërblim të bukur.”²³

²¹ Junus, 57.

²² El-Isra`, 9.

²³ El-Kehf, 1-2.

Dhe thotë Folësi më Krenar, i Përsosuri nga çdo e metë:

بَلْ هُوَ قُرْآنٌ مَّجِيدٌ ﴿٢١﴾ فِي لَوْحٍ مَّحْفُوظٍ ﴿٢٢﴾

“Përkundrazi, ai është një Kuran i lavdishëm, në Pllakën e Ruajtur mirë (Leuhi Mahfûdh).”²⁴

Dhe thotë Krenari e i Madhërishmi:

إِنَّهُ لَقُرْآنٌ كَرِيمٌ ﴿٧٧﴾ فِي كِتَابٍ مَّكْنُونٍ ﴿٧٨﴾ لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ ﴿٧٩﴾ تَنْزِيلٌ مِّن رَّبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٨٠﴾

“Ky është vërtet një Kuran i nderuar, në Librin e ruajtur. Atë e prekin vetëm të pastërtit. Ai është Shpallje prej Zotit të botëve.”²⁵

Si dhe mjaft ajete të tjera që përmbajnë emrat e këtij Libri madhështor dhe cilësitë e tij që të tregojnë madhësitinë e Fuqisë së Tij dhe lartësinë e Fisnikërisë së të Tij.

E si mos të jetë kështu kur folësi tek ky libër është Zoti i zotërve, i Përsosuri nga çdo e metë, Ai që e di të Fshtetën dhe të Dukshmen, Ai që ka thënë:

وَلَوْ أَنَّمَا فِي الْأَرْضِ مِنْ شَجَرَةٍ أَقْلَمٌ وَالْبَحْرُ يَمُدُّهُ مِنْ بَعْدِهِ سَبْعَةُ أَنْحَارٍ مَا نَفَذْتُ كَلِمَتُ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢٧﴾

“Sikur të gjithë drurët që gjenden në Tokë të ishin pena e deti bojë shkrimi, e t’i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të

²⁴ El-Buruxh, 21-22.

²⁵ El-Uaki’ah, 77-80.

shtereshin fjalët e Allahut. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”²⁶

Ajo që duhet ditur është se çdo emër apo cilësi e këtij Libri madhështor është një tregues i kuptimit që është i veçantë për të.

Dhe sikur të mos frikësoheshim se po e zgjasim shumë, ne do t'i kishim treguar pikat e përgjithshme duke i shpjeguar ato me hollësi, me anë të së cilave do të kuptohej pjesa tjetër që mbetet (nga kjo broshurë).

Gjithashtu, prej veçantive të këtij Libri fisnik është se Allahu i Madhëruar ka garantuar ruajtjen e tij (nga çdo lloj dëmtimi) dhe nuk ia ka ngarkuar askujt prej krijesave të Tij mbrojtjen e Kur'anit..

Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿٩٦﴾

“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”²⁷

Dhe Allahu i Madhëruar thotë:

بَلْ هُوَ قُرْآنٌ مَّجِيدٌ ﴿١١﴾ فِي لَوْحٍ مَّحْفُوظٍ ﴿١٢﴾

“Përkundrazi, ai është një Kur'an i lavdishëm, në Pllakën e Ruajtur mirë (*Leuhi Mahfûdh*).”²⁸

Dhe ka thënë Ibnul-Kajjim, Allahu e mëshiroftë: “Pra, i Përsosuri nga çdo e metë e ka përshkruar atë (Kur'anin) në thënien e Tij se ai është i mbrojtur:

²⁶ Lukman, 27.

²⁷ El-Hixhr, 9.

²⁸ El-Buruxh, 21-22.

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿٩﴾

“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kur'anin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”²⁹

Ai e ka përkrahur pozitën e tij në këtë sure – sureja el-Buruxh – se ai është i mbrojtur, kështu që Allahu i Përsosur nga çdo e metë e ka ruajtur pozitën e tij, e ka ruajtur nga shtesat, nga cungimet dhe nga tjetërsimet. Ai i ka ruajtur domethëniet e tij nga deformimet, ashtu siç ka ruajtur fjalët e tij nga tjetërsimi, si dhe ka nxjerrë njerëz që do t'i ruajnë shkronjat e tij nga shtimi apo mangësi dhe do t'i ruajnë kuptimet e tij nga shtrembërimi apo tjetërsimi.”³⁰

Libri i nderuar i Allahut është ai që të shpëton nga fitnet, shoku më i ngushtë i Besimtarit, drita e zemrës së tij, pranvera e gjoksit të tij, larguesi i brengave dhe pikëllimit të tij.

Libri i Allahut na njofton se çfarë ka ndodhur më përpara dhe çfarë do të ndodhë më pas, si dhe gjykon për çdo çështje mes nesh.

Ai ndan të drejtën nga e padrejta e nuk është kurrësesi shaka.

Kush e braktis atë nga mendjemadhësia, Allahu do ta shkatërrojë; dhe kush kërkon udhëzim tjetër në vend të tij, Allahu do ta humbasë.

Ai është litari i pakëputshëm i Allahut, përkujtuesi i urtë, rruga e drejtë.

Nëse e ndjek atë, epshet nuk mund të të largojnë prej tij dhe as gjuhët e të devijuarve nuk mund të të mashtrojnë.

²⁹ El-Hixhr, 9.

³⁰ *Et-Tibjan fi Aksamil-Kur'an* (1/62), i Imam Shemsud-Din Muhamed Ibn Ebij Bekr, i njohur si Ibn Kajjim el-Xheuzijeh, bot. Daar Tiba'atu el-Muhamedijeh në Ez'her, shpërndarë nga Drejtoria e Përgjithshme e Hulumtimeve Shkencore dhe Fetvasë në Rrijad.

Dijetarët nuk ngopen me të (për shkak të dijes së pafund që përmban ai), nuk konsumohet nga ripërsëritja e leximit të tij, nuk ka të sosur mahnitja nga ai dhe nuk kanë të mbaruar mësimet e tij.

Ai nuk mund të mohohet, mahnitja me të nuk zvogëlohet dhe kufijtë e tij nuk mund të kalohen. Është ai që Xhinët nuk e mohuan kur e dëgjuan dhe thanë:

إِنَّا سَمِعْنَا قُرْءَانًا عَجَبًا ﴿١﴾

“Me të vërtetë, kemi dëgjuar një Kuran të mrekullueshëm.”³¹

Kush flet me të ka thënë të vërtetën dhe kush gjykon me të ka gjykuar me drejtësi; kush vepron në përputhje me të e fitoi shpërblimin dhe kush i thërret të tjerët tek ai ka udhëzuar në rrugën e drejtë. Ai është shenja më e madhe dhe mrekullia më madhështore që i është dhënë Pejgamberit tonë (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), me ç'rast ai ka thënë:

« ما من الأنبياء من نبي إلا قد أعطي من الآيات ما مثله آمن عليه البشر ، وإنما كان الذي أوتيت وحيا أوحى الله إلي ، فأرجو أن أكون أكثرهم تابعا يوم القيامة »

“Nuk ka pas Pejgamber që të mos i jenë dhënë shenja të cilat iu janë dhënë edhe Pejgamberëve të mëparshëm dhe njerëzit i besuan ato. Me të vërtetë, edhe mua më është dhënë shpallje nga Allahu dhe unë shpresoj që të kem më shumë pasues se ata në Ditën e Ringjalljes.”³²



³¹ El-Xhinn, 1.

³² Zinxhiri i tij është transmetuar tek dy Sahihët: Sahih el-Bukhari (1/97; 8/138; 139), bot. Mektebeh el-Islmijeh, Stamboll; Sahih Muslim (n.152) dhe teksti është nga ai; nga hadithi i Ebu Hurejrës (*radij-Allahu 'anhu*).



- Ai të mrekullon me fjalët e tij dhe me sqarimin që përmbajnë ato:

وَإِنْ كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّثْلِهِ ۚ وَادْعُوا شُهَدَاءَكُمْ مِّنْ

دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٣﴾

“Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tonë (Muhamedit), atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj (që i adhuroni) në vend të Allahut, nëse jeni të singertë.”³³

- Ai të mrekullon me lehtësinë e recitimit dhe leximi të tij:

وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُّذَكِّرٍ ﴿١٧﴾

“Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t’u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!”³⁴

- Ai të mrekullon me historitë që rrëfihen në të rreth asaj që ndodhur më përpara me qëllim që të reflektojmë mbi to:

³³ El-Bekareh, 23.

³⁴ El-Kamer, 17.

لَحْنُ نَقْصٍ عَلَيْكَ أَحْسَنَ الْقَصَصِ بِمَا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ هَذَا الْقُرْآنَ وَإِنْ كُنْتَ مِنْ

قَبْلِهِ لَمَنِ الْغَفْلِينَ ﴿٣٥﴾

“Ne të tregojmë ty (Muhamed) historitë më të bukura përmes shpalljes së këtij Kur’ani, ndonëse ti, me të vërtetë, nuk ke qenë në dijeni më parë.”³⁵

Dhe thotë i Përsosuri nga çdo e metë:

لَقَدْ كَانَتْ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِأُولَى الْأَلْبَابِ ۚ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِنْ تَصْدِيقَ

الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٣٦﴾

“Në tregimet e atyre (të dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend. Ky (Kur’an) nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i atyre (librave) që janë shpallur para tij, është shpjegues i çdo gjëje dhe udhërrëfyes e mëshirë për njerëzit që besojnë.”³⁶

- Ai të mrekullon me aspektet e besimit dhe ligjet e Fesë që gjenden në të - të cilat e kemi detyrë t’i ndjekim e t’i zbatojmë:

الرَّ كَتَبَ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِ رَبِّهِمْ

إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ﴿٣٧﴾

“Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”³⁷

³⁵ Jusuf, 3.

³⁶ Jusuf, 111.

³⁷ Ibrahim, 1.

dhe:

وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ تَبْيِينًا لِّكُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً وَبُشْرَىٰ لِلْمُسْلِمِينَ ﴿٨٩﴾

“Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë, udhëzim dhe përgëzim për muslimanët.”³⁸

dhe:

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ بِالْحَقِّ فَاْعْبُدِ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الدِّينَ ﴿٩٠﴾

“Sigurisht, Ne ta kemi zbritur ty Librin me të vërtetën. Andaj adhuro vetëm Allahun me përkushtim të çiltër për Të!”³⁹

dhe:

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿٩١﴾

“Ky Libër që kemi shpallur është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe kini frikë (Allahun), në mënyrë që të mëshiroheni.”⁴⁰

- Ai të mrekullon me informacionet që përmban rreth Gajbit (të Fshehtës), të cilat duhet t'i besojmë dhe duhet t'u nënshtrohemi:

الْم ﴿٩٢﴾ ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٩٣﴾ الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ

وُيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ ﴿٩٤﴾

“Elif, Lâ, Mîm. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që Ne u kemi dhënë.”⁴¹

³⁸ En-Nahl, 89.

³⁹ Ez-Zumer, 2.

⁴⁰ El-En'am, 155.

⁴¹ El-Bekare, 1-3.

Ai ka ajete të qarta dhe argumente vezulluese - që nga dërgimi i Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) e deri kur Allahu do të japë leje për ngritjen e tij (pra deri në Orën e Fundit).

Me të Allahu sfidoi njerëzit më oratorë e elokuentë, por ata qenë të paafte. Madje Ai i sfidoi xhinët dhe njerëzit bashkë dhe i zmbapsi ata duke thënë:

قُلْ لِّينِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَى أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ

كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا

“Thuaj: Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhinët për të hartuar një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin.”⁴²

Ai është një mirësi që Allahu ia dha Pejgamberit të Tij (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*):

وَلَقَدْ ءَاتَيْنَاكَ سَبْعًا مِّنَ الْمَثَانِي وَالْقُرْآنَ الْعَظِيمَ

“Ne të kemi dhënë ty shtatë vargje që përsëriten dhe Kur'anin e madhërishëm.”⁴³

- Ai të udhëzon në Rrugën e Drejtë dhe në Menhexhin (metodologjinë) e Saktë:

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ

“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira.”⁴⁴



⁴² El-Isra, 88.

⁴³ El-Hixhr, 87.

⁴⁴ El-Isra`, 9.



Për më tepër, në recitimin e këtij libri ka shpërblim mjaft të madh, një dobi të jashtëzakonshme. Allahu thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا
وَعَلَانِيَةً يَرْجُونَ تَجَرَّةً لَّنْ تَبُورَ ﴿٢٩﴾ لِيُؤْفِقَهُمُ أَجُورَهُمْ وَيَزِيدَهُم مِّنْ
فَضْلِهِ ۚ إِنَّهُ غَفُورٌ شَكُورٌ ﴿٣٠﴾

“Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që Ne u kemi dhënë, shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë kurrë. Allahu do t’ua plotësojë atyre shpërblimin dhe do t’u shtojë nga dhuntitë e Tij. Me të vërtetë, Ai është Falës dhe Pranues i veprave të tyre të mira.”⁴⁵

Dhe (është transmetuar) nga Ibn ‘Umeri (*radij-Allahu ‘anhuma*), se Pejgamberi (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ لا حسد إلا في اثنتين: رجل آتاه الله القرآن فهو يقوم به آناء الليل و آناء النهار،
و رجل آتاه الله مالا فهو ينفقه آناء الليل و آناء النهار. ﴾

⁴⁵ El-Fatir, 29-30.

“Nuk ka based veçse për dy persona: personi të cilit Allahu i ka dhënë Kur'anin dhe ai e lexon atë natën dhe ditën; dhe personi të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon atë natën dhe ditën (në rrugën e Allahut).”⁴⁶ Transmetuar nga Bukhari dhe Muslimi.

Dhe nga Ibn Mes'udi (*radij-Allahu 'anhu*), se ai (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ من قرأ حرفاً من كتاب الله تعالى فله به حسنة، والحسنة بعشر أمثالها، لا أقول: **الـم حرف، و لكن ألف حرف و لام حرف، و ميم حرف .** ﴾

“Kush lexon një shkronjë nga Libri i Allahut të Lartësuar, atëherë kjo do të llogaritet një vepër e mirë dhe kjo vepër e mirë është e barabartë me dhjetë vepra të mira. Unë nuk po them që Elif Lam Mim është një shkronjë, por Elif është një shkronjë, Lam është një shkronjë dhe Mim është një shkronjë.”⁴⁷



⁴⁶ Sahih el-Bukhari (8/209) dhe Sahih Muslim (n.810) dhe teksti është tek ai.

⁴⁷ Sunen et-Tirmidhi i Imamit Ebij 'Ijsa Muhamed Ibn 'Ijsa Ibn Surah et-Tirmidhi, me verifikim dhe shpjegim të Ahmed Muhamed Shakir (n.2910), bot. Daar el-Kutub el-'Ilmijeh, Bejrut. Dhe tha Tirmidhiu: “Ky hadith është transmetuar edhe në një formë tjetër ndryshe nga ai që është transmetuar nga Ibn Mes'udi, e ka transmetuar Ebul-Ahues nga Ibn Mes'udi, disa e kanë transmetuar në formë merfuë, kurse disa në formë meukuf nga Ibn Mes'udi.” Tha Ebu 'Ijsa: “Ky hadith është hasen sahih, garib nga ky transmetim. E kam dëgjuar Kutejben të thotë: “Më kanë përcjellë se Muhamed Ibn Ka'b el-Kuradhij lindi kur Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ishte gjallë, dhe llagapi i tij ishte Eba Hamzah.”



Poseduesi i Kur'anit do të ketë gradat më të larta Ditën e Kijametit, prej tyre:

Nga 'Umer Ibnul-Khattab (*radij-Allahu 'anh*) i cili ka thënë se Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ إن الله تعالى يرفع بهذا الكتاب أقواما ويضع به آخرين ﴾

“Me të vërtetë Allahu i Lartësuar me këtë Libër i ngre disa njerëz, kurse disa të tjerë i ul.”⁴⁸

Dhe nga Ibn Mes'ud el-Ensarij el-Bedri (radij-Allahu 'anh) se i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ يَوْمَ الْقَوْمِ أَقْرَأُ لَهُمْ لِكِتَابِ اللَّهِ ﴾

“Njerëzit udhëhiqen (në namaz) nga më të zotët në leximin e Librit të Allahut mes tyre.”⁴⁹

Ka thënë Ibn 'Abbasi (*radij-Allahu 'anhuma*):

“Recituesit e Kur'anit ishin pjesëtarë të mbledhjeve të 'Umerit (*radij-Allahu 'anh*) dhe ishin këshilltarët e tij, pavarisist nëse ishin të vjetër apo të rinj në moshë.”⁵⁰

⁴⁸ Sahih Muslim (n. 817).

⁴⁹ Sahih Muslim (n. 673).

⁵⁰ Sahih el-Bukhari (8/141).

Nga Ebij Musa el-Esh'arij (*radij-Allahu 'anhu*) i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ إن من إجلال الله تعالى إكرام ذي الشيبة المسلم ، وحامل القرآن غير الغالي فيه والجافي عنه ، وإكرام ذي السلطان المقسط. ﴾

“Vërtet, prej madhërimit të Allahut të Lartësuar është nderimi i Muslimanit të moshuar; nderimi i atij që ka mësuar Kur'anin dhe nuk i kalon kufijtë e tij dhe as nuk bën lëshime në të; dhe nderimi i prijësit të drejtë.”⁵¹

Poashtu, nga Ebij Musa el-Esh'arij (*radij-Allahu 'anhu*) i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ مثل المؤمن الذي يقرأ القرآن كمثل الأترجة، ريحها طيب وطعمها طيب ، ومثل المؤمن الذي لا يقرأ القرآن مثل التمرة ، لا ريح لها وطعمها حلو ، ومثل المنافق الذي يقرأ القرآن مثل الريحانة ، ريحها طيب وطعمها مر ، ومثل المنافق الذي لا يقرأ القرآن كمثل الحنظلة ، ليس لها ريح وطعمها مر. ﴾

“Shembulli i besimtarit që e lexon Kur'anin është si qitroja e cila ka aromë të mirë dhe shije të mirë. Shembulli i besimtarit që nuk e lexon Kur'anin është si hurma që nuk ka aromë, mirëpo shija e saj është e ëmbël. Shembulli i munafikut që e lexon Kur'anin është si borziloku që ka aromë të mirë, mirëpo shija e tij është e hidhur. Kurse shembulli i munafikut që nuk e lexon Kur'anin është si kungulli i egër i cili nuk ka aromë dhe shija e tij është e hidhur.”⁵²

Pra, kjo (gradë e lexuesit të Kur'anit) është në jetën e kësaj bote. Kurse në botën tjetër fitimi i tij do të jetë më i madh nëse punon me të, shpërblimi i tij do të jetë akoma më i madh.

Nga 'A`ishah (*radij-Allahu 'anha*) e cila ka thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*):

⁵¹ Sunen Ebij Davud (n. 4843), i Imam Ebij Davud Sulejman Ibnul-Esh'ath es-Sixhistanij, bot. Daar el-Hadijth, Hims, Siri.

⁵² Muttefekun alejhi: Sahih el-Bukhari (6/207) dhe teksti i mësipërm është i tij; Sahih Muslim (n. 797).

﴿ الماهر بالقرآن مع السفرة الكرام البررة، والذي يقرأ القرآن ويتتعتع فيه وهو عليه شاق ، له أجران. ﴾

“Ai i cili e lexon Kur'anin me zotësi do të jetë me Shkruesit Fisnikë (Melaiket), kurse ai që e lexon Kur'anin me vështirësi do të ketë dy shpërblime.”⁵³

Nga Ebij Umameh el-Bahilij (radij-Allahu 'anhu) i cili ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem) të thotë:

﴿ اقرءوا القرآن ، فإنه يأتي يوم القيامة شفيعا لأصحابه. ﴾

“Lexojeni Kur'anin sepse Ditën e Kijametit ai do të vijë si ndërmjetësues për poseduesin e tij.”⁵⁴

Dhe poseduesi i Kur'anit është ai i cili do të vendoset në vendet e para në Botën Tjetër.

Nga Xhabir Ibn 'Abdullah (radij-Allahu 'anhu) se i Dërguari i Allahut (sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem) qefinoste bashkë dy njerëz nga të vrarët në Uhud dhe thoshte:

﴿ أيهم أكثر أخذًا للقرآن ؟ ﴾

“Cili prej tyre kishte mësuar më shumë Kur'an?”

Dhe nëse i tregonin se njëri prej tyre kishte mësuar më shumë, atëherë atë e vendoste të parin në varr.”⁵⁵

Poseduesi i Kur'anit nuk do të ndalet së ngrituri në gradat e larta të Xhenetit në varësi të asaj që ka mësuar nga Kur'an.

⁵³ Sahih el-Bukhari (6/80) dhe Muslimi (n. 798) dhe teksti i mësipërm është nga ai.

⁵⁴ Sahih Muslim (n. 804).

⁵⁵ Sahih el-Bukhari (2/93).

Dhe nga Ebij Umameh el-Bahilij (*radij-Allahu 'anhu*) se Pejgamberi (*sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿يقال لصاحب القرآن : اقرأ وارتق ورتل كما كنت ترتل في الدنيا ، فإن منزلتك عند آخر آية تقرؤها.﴾

“Do t’i thubet poseduesit të Kur'anit: Recito dhe ngrihu (në grada), këndoje avash ashtu siç e këndoje në dynja, ngase me të vërtetë grada jote (në Xhenet) është deri në ajetin e fundit që do të lexosh.”⁵⁶



القرآن الكريم

⁵⁶ Sunen Ebij Davud (n. 1464) dhe teksti është i tij; Sunen et-Tirmidhij (n. 2914) dhe tha: Hadith Hasen Sahih.



Nuk ka dyshim se vëmendja dhe kujdesi në mësimin përmendësh të Kur'anit është nga zelli që ka njeriu për të, ngase kjo vepër ka shpërblim madhështor. Dhe ky Umet është përshkruar në Librat e Mëparshëm se ata do ta mbajnë librin e tyre të shenjtë në zemrat e tyre.⁵⁷ Dhe kështu është, ngase Allahu i Përsosur nga çdo e metë na ka njoftuar në Librin e Tij se ky Libër është i ruajtur në zemrat e njerëzve:

وَمَا كُنْتُمْ تَتْلُوا مِنْ قَبْلِهِ مِنْ كِتَابٍ وَلَا تَخُطُّهُمْ بِيَمِينِكُمْ إِذَا لَأَرْتَابَ
 الْمُبْطِلُونَ ﴿٤٨﴾ بَلْ هُوَ آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ فِي صُدُورِ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ
 وَمَا تَجْحَدُ بِآيَاتِنَا إِلَّا الظَّالِمُونَ ﴿٤٩﴾

“Para këtij ti (o Muhamed) nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin. Përkundrazi! Ato janë ajete të qarta në zemrat e atyre të cilëve u është dhënë dija. Dhe askush nuk i mohon argumentet Tona përveç zullumqarëve.”⁵⁸

⁵⁷ Shiko: *Tefsir el-Kur'anil-'Adhijm*, i Imam 'Imadud-Din Ebil-Fida` Isma'il Ibn Kethiir el-Kurashij ed-Dimeshkij, ajeti n.49 i sures el-Ankebut (3/514-515), botimi i parë 1415 H, Daar Ibn Kethiir, Damask.

⁵⁸ El-Ankebut, 48-49.

Pra, i Lartësuari ka bërë të ditur se Kur'ani është i ruajtur në zemrat e Dijetarëve. Dhe kjo vërtetohet në hadithin e shenjtë (*kudsij*) ku thuhet:

﴿ إِنَّمَا بَعَثْتُكَ لِأَبْتَلِيكَ وَأَبْتَلِي بِكَ ، وَأَنْزَلْتُ عَلَيْكَ كِتَابًا لَا يَغْسِلُهُ الْمَاءُ ﴾

*“Vërtet, Unë ju dërgova vetëm që t’u sprovtoj dhe të sprovtoj të tjerët nëpërmjet jush dhe ju zbrita Librin i cili nuk do të shpëlahet nga uji.”*⁵⁹

Kuptimi i tij është: se uji nuk e fshin atë, ngase ai është i ruajtur në zemra.

Pejgamberi (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) e ka përngjasuar atë që nuk mëson asgjë përmendësh nga Kur'ani me shtëpinë e rrënuar.

Nga Ibn ‘Abbasi (*radij-Allahu ‘anhuma*) i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ إِنَّ الَّذِي لَيْسَ فِي جَوْفِهِ شَيْءٌ مِنَ الْقُرْآنِ كَالْبَيْتِ الْخَرِبِ. ﴾

*“Vërtet, ai i cili nuk ka brenda tij asgjë nga Kur'ani është si shtëpia e rrënuar.”*⁶⁰

Dhe u përmend më përpara kuptimi i haditheve të cilat tregojnë nderin e poseduesit të Kur'anit dhe pozitën e tij madhështore.



⁵⁹ Transmetuar nga Muslimi.

⁶⁰ Transmetuar nga Tirmidhiu në Sunenin e tij (n. 2913) dhe ka thënë se është hasen sahih.



Pjesa e obligueshme për t'u mësuar përmendësh nga Kur'ani

Mësmi përmendësh i Kur'anit është i ligjshëm për Muslimanin. Dhe pjesa e obligueshme për t'u mësuar përmendësh nga ai është aq sa ka nevojë ai për të saktësuar ibadetin e tij.

Shejkhul-Islam Ibn Tejmijeh (*rahimehullah*) ka thënë: “Për sa i përket mësimi përmendësh të të gjithë Kur'anit dhe kuptimit të të gjitha domethënive të tij dhe njohjen e të gjithë Sunetit, atëherë kjo nuk është obligim për cilindo. Por, obligim për robin është që të mësojë përmendësh Kur'anin, të mësojë domethëniet e tij dhe të kuptojë Sunetin për aq sa i nevojitet atij.”⁶¹



⁶¹ Mexhmu'ul-Fetaua Shejkhul-Islam Ibn Tejmijeh (15/391), me verifikimin e 'Abdur-Rahman Ibn Kasim dhe i biri i tij Muhamed (*rahimehumaAllah*); bot. Daar 'Alimul-Kutub, Rrijad.



Vërtet, prej atyre çështjeve që duhen patur parasysh nga ai që do të recitojë Kur'anin apo ta mësojë përmendësh atë janë:

Para: Obligimi i sinqeritetit për Allahun në veprat që bën për Të dhe jo të ketë për qëllim gjërat e pavlera të kësaj dynjaje, ngase Allahu i Lartësuar thotë:

مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا وَزِينَتَهَا نُوَفِّ إِلَيْهِمْ أَعْمَلَهُمْ فِيهَا وَهُمْ فِيهَا لَا يُبْخَسُونَ ﴿١٥﴾ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ لَيْسَ لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ إِلَّا النَّارُ وَحَبِطَ مَا صَنَعُوا فِيهَا وَبَاطِلٌ مَّا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٦﴾

“Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t’ua shpërblejmë krejtësisht punët e tyre dhe në të nuk do t’u lihet gjë mangët. Këta janë ata për të cilët në botën tjetër nuk do të kenë kurrigjë, përveç zjarrit. Do t’u shembet çdo gjë që kanë bërë në këtë jetë dhe do t’u zhvlerësohet ajo që kanë punuar.”⁶²

Dhe thotë i Lartësuari:

⁶² Hud, 15-16.

مَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الْآخِرَةِ نَزِدْ لَهُ فِي حَرْثِهِ ۖ وَمَنْ كَانَ يُرِيدُ حَرْثَ الدُّنْيَا نُؤْتِهِ مِنْهَا وَمَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ نَصِيبٍ ﴿٦٣﴾

“Atij që dëshiron shpërblim në jetën tjetër, Ne do t’ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t’i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në jetën tjetër.”⁶³

Dhe thotë i Madhëruari e i Lartësuari:

مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْعَاجِلَةَ عَجَّلْنَا لَهُ فِيهَا مَا نَشَاءُ لِمَنْ نُرِيدُ ثُمَّ جَعَلْنَا لَهُ جَهَنَّمَ يَصْلَاهَا مَذْمُومًا مَدْحُورًا ﴿٦٤﴾

“Sa për atë që dëshiron këtë botë, Ne shpejtojmë t’i japim çfarë të dëshirojmë kujt të duam. Pastaj ia caktojmë atij Xhehenemin në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar.”⁶⁴

Dhe ka ardhur në Sahihun e Muslimit nga Ebij Hurejrah (*radij-Allahu ‘anhu*) se Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

« إن أول الناس يقضى يوم القيامة عليه رجل استشهد ، فأتي به فعرفه نعمه فعرفها ، قال : فما عملت فيها ؟ قال : قاتلت فيك حتى استشهدت . قال : كذبت ، ولكنك قاتلت لأن يقال : جريء ، فقد قيل . ثم أمر به فسحب على وجهه حتى ألقي في النار . ورجل تعلم العلم وعلمه وقرأ القرآن ، فأتي به فعرفه نعمه فعرفها . قال : فما عملت فيها ؟ قال : تعلمت العلم وعلمته ، وقرأت فيك القرآن . قال : كذبت ، ولكنك تعلمت العلم ليقال : عالم ، وقرأت القرآن ليقال : هو قارئ ، فقد قيل . ثم أمر به فسحب على وجهه حتى ألقي في النار . »

⁶³ Esh-Shuura, 20.

⁶⁴ El-Isra, 18.

“Vërtet, nga njerëzit e parë që do të gjykohen në Ditën e Gjykimit do të jetë një burrë që vdiq si shehid. Ai do të sillet dhe Allahu do t'i bëjë të ditur mirësitë e Tij e ai do t'i njohë ato. Ai do t'i thotë: “Çfarë bërë ti për t'i fituar këto mirësi?” Ai do të thotë: “Kam luftuar për hirin Tënd derisa rashë shehid.” Ai do të thotë: “Gënjeve! Ti luftove me qëllim që të thubej për ty se je guximtar, e kështu është thënë me të vërtetë.” Pastaj, jepet urdhër që ky njeri të tërhiqet zvarrë me fytyrën e tij derisa të hidhet në Zjarr.

Njeriu tjetër që do të gjykohet është ai që mori dije, ua mësoi atë të tjerëve dhe ka lexuar Kur'anin. Allahu do të thotë: “Çfarë bërë ti për t'i fituar këto mirësi?” Ai do të thotë: “Unë mora dije, ua mësova atë të tjerëve dhe e lexova Kur'anin për Ty.” Allahu do të thotë: “Gënjeve! Ti e mësove me qëllim që të thubej për ty se je Dijetar dhe e lexove Kur'anin që të thubej se ti e lexon atë, e kështu është thënë me të vërtetë.” Pastaj, jepet urdhër që ky njeri të tërhiqet zvarrë me fytyrën e tij derisa të hidhet në Zjarr.

Njeriu i tretë që do të sillet para Allahut do të jetë pasaniku të cilit Allahu i kishte dhënë çdo lloj pasurie. Allahu do t'i bëjë të ditur mirësitë e Tij e ai do t'i njohë ato. Ai do t'i thotë: “Çfarë bërë ti për t'i fituar këto mirësi?” Ai do të thotë: “Unë nuk lashë rrugë pa e shpenzuar këtë pasuri për hirin Tënd.” Allahu do t'i thotë: Gënjeve! Ti e ke bërë këtë me qëllim që të thubej për ty se je bujar, e kështu është thënë me të vërtetë.” Pastaj, jepet urdhër që ky njeri të tërhiqet zvarrë me fytyrën e tij derisa të hidhet në Zjarr.”⁶⁵

Allahu na ruajt nga gjendja e keqe.

Ka thënë Ibnul-Kajjim (*rahimebullah*) pasi që përcjell këtë hadith: “E dëgjova Shejkhul-Islam (Ibn Tejmijen) të thotë: “Ashtu sikurse njerëzit më të mirë janë Pejgamberët, njerëzit më të këqinj janë gënjeshtarët që i imitojnë Pejgamberët dhe pretendojnë se janë të tillë ndërkohë që nuk janë. Dhe njerëzit më të mirë mbas Pejgamberëve janë Dijetarët, Shehidët, Siddikunët (ata që thonë të vërtetën) dhe të Singertët. Kurse njerëzit më të këqinj janë ata që i imitojnë duke menduar se janë prej tyre, ndërkohë që nuk janë.”⁶⁶

⁶⁵ Sahih Muslim (n. 1905).

⁶⁶ El'Xheuabul-Kafi limen se` ele 'an ed-Da'ui esh-Shafi', fq. 20. [Darul-Kutub el-Ilmijeh]

E dyta: Ai që do të mësojë përmendësh Kur'anin duhet ta përsërisë atë pjesë që ka mësuar përmendësh derisa ta mbaj mend mirë. Dhe nëse Allahu i Lartësuar shikon sinqeritet tek rob i Tij, atëherë Ai ia bën të lehtë rrugën e mësimi përmendësh.

وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُدَكِّرٍ ﴿١٧﴾

“Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t’u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!”⁶⁷

E treta: Kush ka mësuar përmendësh diçka prej Kur'anit duhet të bëjë kujdes duke e përsëritur e duke e rishikuar derisa të mos e ngatërrojë. Gjithashtu, ai duhet të kërkojë ndihmë në namazin e tij, ngase ai që falet duke lexuar atë pjesë që ka mësuar nga Kur'ani nuk e harron atë.

Nga Ibn 'Umeri (*radij-Allahu 'anhuma*) i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ إِنَّمَا مِثْلُ صَاحِبِ الْقُرْآنِ كَمِثْلِ الْإِبِلِ الْمَعْلُوقَةِ ،
إِنْ عَاهَدَ عَلَيْهَا أَمْسَكَهَا ، وَإِنْ أَطْلَقَهَا ذَهَبَتْ . ۞ ﴾

“Vërtet, shembulli i atij që e ka mësuar Kur'anin është si shembulli i deveve të lidhura; nëse mbahen të lidhura janë nën kontroll. Por nëse liben të lira, ato do të ikin.”⁶⁸

Kurse Muslimi ka shtuar më tej në një tjetër transmetim:

﴿ وَإِذَا قَامَ صَاحِبُ الْقُرْآنِ فَقَرَأَهُ بِاللَّيْلِ وَالنَّهَارِ ذَكَرَهُ ،
وَإِذَا لَمْ يَقُمْ بِهِ نَسِيَهُ ۞ ﴾

“Nëse ai që e ka mësuar Kur'anin e lexon atë natën dhe ditën, e mban mend atë; e nëse nuk vepron ashtu e harron.”⁶⁹

⁶⁷ El-Kamer, 17.

⁶⁸ **Muttefekun alejhi:** Bukhari (6/109) dhe Muslimi (n. 789, 226) dhe teksti është i tiji.

⁶⁹ Sahih Muslim (n. 227, 789).

E katërta: prej shkaqeve që të ndihmojnë në mësimin përmendësh të Kur'anit është studimi i tij. Vërtet, Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) e studjonte Kur'anin me Xhibrilin (*'alejhis-selam*) një herë në vit, përveç vitit kur vdiq, në të cilin e studjoi Kur'anin me të dy herë.

Dhe thotë i Dërguari (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) për virtytin e studimit të Kur'ani:

وما اجتمع قوم في بيت من بيوت الله ، يتلون كتاب الله ،
ويتدارسونه بينهم ، إلا نزلت عليهم السكينة ، وغشيتهم الرحمة
، وحفتهم الملائكة ، وذكرهم الله فيمن عنده ،

*“Nuk ka njerëz që mbledhen në ndonjë prej shtëpive të Allahut ku lexojnë Librin e Allahut dhe e studjojnë me njëri-tjetrin, e të mos zëbresë mbi ta qetësia dhe i mbulon mëshira, melaiket mbledhen rreth tyre dhe i përmend Allahu tek ata që janë pranë Tij...”*⁷⁰

E pesta: Duhet që Muslimani të mos jetë i shkujdesur me Librin e Allahut por ta lexojë atë nga fillimi deri në fund. Selefët e kishin zakon që ta lexonin të gjithë Kur'anin. Mes tyre kishte që e lexonin të plotë një herë në dy muaj, mes tyre kishte që e lexonin të plotë një herë në muaj, mes tyre kishte që e lexonin çdo dhjetë netë, mes tyre kishte që e lexonin çdo tetë netë, shumë prej tyre e lexonin çdo shtatë netë, dhe kishte prej tyre që e lexonin në më pak se të tjerët.

Më e mira është që Muslimani ta përfundojë leximin e krejt Kur'anit për shtatë netë, siç kanë bërë shumica e Sahabëve, saqë ata e ndanë Kur'anin në shtatë pjesë. Transmetohet nga Eus Ibn Hudhejfeh i cili ka thënë: “I pyeta shokët e të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) si e ndanin Kur'anin dhe thanë: “Në tre, pesë, shtatë, nëntë, njëmbëdhjetë dhe trembëdhjetë pjesë, kurse pjesën *el-Mufasssal* e linin më vete.”⁷¹

⁷⁰ Transmeton Imam Ahmedi në Musnedin e tij (2/252) bot. *El-Mejmunijeh*, Muslimi në Sahihun e tij (n. 2699) dhe Ebu Davudi në Sunenin e tij (n. 1455), nga hadithi i Ebu Hurejrës (radij-Allahu 'anhu).

⁷¹ Transmetuar nga Ebu Davudi në Sunenin e tij (n. 1393).

Pjesa *el-Mufasssal* është që nga sureja Kaf deri në fund të Kur'anit Madhështor.

Dhe sepse Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) i tha 'Abdullah Ibn 'Amru Ibnul-'Asit (*radij-Allahu 'anhuma*):

﴿ اقرأ القرآن في شهر. ﴾

“Lexoje Kur'anin për një muaj.”

Unë ('Abdullahu) tha: “Unë mund ta lexoj për më pak se aq.” Ai tha:

﴿ فاقراه في سبع ولا تزيد على ذلك ﴾

“Atëherë lexoje për shtatë ditë dhe mos kalo përtej kësaj.”⁷²

Ndërsa ai që e lexon Kur'anin për më pak se aq, shumicën e rasteve ai nuk e kupton atë që lexon dhe kjo nuk është gjë e mirë për Muslimanin.

Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë, siç ka ardhur në hadithin e 'Abdullah Ibn 'Amru Ibnul-'As (*radij-Allahu 'anhuma*):

﴿ لا يفقه من قرأ القرآن في أقل من ثلاث ﴾

“Nuk e kupton Kur'anin ai i cili e lexon atë për më pak se tre ditë.”⁷³ E kanë transmetuar autorët e katër Suneneve. Ka thënë Tirmidhiu: Hasen Sahih.

Prandaj Suneti është që të mos të kompletohet leximi i Kur'anit për më pak se tre ditë.

Dhe njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri në këtë, ngase mes tyre ka të atillë që kanë më shumë dije, kuptim të mprehtë, lexim të shpejtë dhe nuk kanë

⁷² Sahih Bukhari (n. 6/114), Sahih Muslim (n. 1159), dhe teksti është nga Bukhari.

⁷³ Sunen Ebij Davud (n. 1394), Sunen Tirmidhi (n. 2946, 2949), Sunen el-Kubra i Nesai`ut (n. 8067), Sunen Ibn Maxheh (n. 1347), Sunen Darimi (n. 1501).

shumë preokupime. Njeriu i tillë lexon më shumë Kur'an sesa ata që janë poshtë tij.

Disa prej Selefëve kanë pëlqyer që kompletimi i leximit të Kur'anit të jetë ose në fillim të natës ose në fillim të ditës. Kjo sepse melaiket bëjnë dua për ata që kompletojnë leximin e Kur'anit natën derisa të gdhijë, si dhe për ata që kompletojnë leximin e Kur'anit ditën deri sa të ngryset. Kjo është transmetuar në formë *meukuf*⁷⁴ nga Se'ad Ibn Ebij Uekas (*radij-Allahu 'anhu*).⁷⁵

Ë gjashta: Muslimani e ka detyrë të përpiket të mësojë atë që lexon derisa ta ketë të qartë dhe ta kuptojë atë që reciton. Kështu, ai do të meditojë rreth tij me frikë-respekt, ngaqë me lexim nuk kihet për qëllim recitimi i Kur'anit. Assesi! Dhe kush është në këtë gjendje (që e lexon Kur'anin pa medituat dhe reflektuar në të) i përngjason gjendjes së Ehli-Kitabëve, për të cilët Allahu ka thënë:

وَمِنْهُمْ أُمِّيُونَ لَا يَعْلَمُونَ الْكِتَابَ إِلَّا أَمَانِي وَإِنَّهُمْ إِلَّا يَظُنُّونَ

“Disa prej atyre janë analfabetë, nuk e njohin Librin, përveç disa trillimeve dhe flasin vetëm me hamendje.”⁷⁶

Domethënë, ata e lexojnë Librin por nuk e kuptojnë ç'ka në të. Shiko Tefsirin e Ibn Kethirit për këtë ajet (1/147).

Me të vërtetë Allahu ka urdhëruar për meditim në Librin e Tij dhe kuptimin e tij në shumë ajete të Kur'anit. Thotë i Lartësuari në suren Jusuf, ajeti 2:

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

⁷⁴ **Shënim i përkthyesit:** Hadithi *Meukuf*: kur zinxhiri i transmetuesve të hadithit përfundon tek Sahabi dhe nuk arrin deri tek Pejgamberi ('*alejhis-salatu ues-salam*).

⁷⁵ Darimiu e ka konsideruar Hasen këtë transmetim në Sunenin e tij (n.3486).

⁷⁶ El-Bekarah, 78.

“Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju.”⁷⁷

Dhe thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُوا الْأَلْبَابِ ﴿٢٨﴾

“Libër i Bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (o Muhamed) për të medituar mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të të zotët e mendjes.”⁷⁸

Allahu i ka qortuar ata që nuk meditojnë në Librin e Tij. Dhe ka thënë Ai i Cili është i Përsosur nga çdo e metë:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا ﴿٢٩﴾

“Vallë, a nuk meditojnë ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!”⁷⁹

Dhe ka thënë gjithashtu:

أَفَلَمْ يَدَّبَّرُوا الْقَوْلَ أَمْ جَاءَهُمْ مَا لَمْ يَأْتِ آبَاءَهُمُ الْأَوَّلِينَ ﴿٣٠﴾

“Vallë, a nuk kanë medituar ata mbi Fjalën (Kur’anin) apo atyre u ka ardhur ajo që nuk u kishte ardhur të parëve të tyre?”⁸⁰

Pejgamberi (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) padyshim që u sqaroi Sahabëve kuptimet e Kur’anit ashtu siç u sqaroi fjalët e tij.

Allahu *‘Azze ue Xhel* thotë:

⁷⁷ Jusuf, 2.

⁷⁸ Saad, 29.

⁷⁹ Muhamed, 24.

⁸⁰ El-Mu’minun, 68.

لَتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ

“...me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur...”⁸¹

Dhe po kështu Tabi’unët e morën shpjegimin e kuptimeve të Kur’anit nga Sahabët. Thotë Muxhahid⁸² (*rahimebullah*): “E kam lexuar Kur’anin para Ibn ‘Abbasit dhe ndaloja në çdo ajet të tij dhe e pyesja atë rreth tyre.” Për këtë arsye (Sufjan) eth-Theurij ka thënë: “Nëse të vjen tefsiri nga Muxhahidi, atëherë ai të mjafton.”

Domethënë: kuptimet e Fjalës së Allahut janë prezente dhe të njohura, shumë prej tyre janë të shkruajtura dhe të përhapura lavdi Allahut. Dhe gjëja më e madhe që shpjegon Kur’anin është vetë Kur’ani, sepse dihet që ky Kur’an ka ajete që përsëriten shpesh dhe janë të ngjashme me njëra-tjetrën.

اللَّهُ نَزَّلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُتَشَابِهًا مَثَانِي

“Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kuranin), libër, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten.”⁸³

Dhe kuptimi është se disa fragmente të tij ngjasojnë me disa të tjera dhe shpjegojnë njëra-tjetrën; dhe rrëfimet në Kur’an përsëriten dhe ndodh që kjo situatë të shpjegojë një situatë tjetër, e kështu me rradhë.

Dhe kjo lavdi Allahut është mëse e qartë se asgjë nuk e shpjegon Fjalën e Allahut më qartë e më shkoqitur sesa vetë Fjala e Allahut. E si të mos jetë kështu kur Allahu i Përsosur nga çdo e metë është Ai që flet me ato fjalë dhe Ai është më i Dituri për kuptimet e tyre. Prandaj Selefët i kushtuan

⁸¹ En-Nahl, 44.

⁸² **Shënim i përkthyesit:** Ai është Muxhahid Ibn Xhebr Ebul-Haxhaxh, Tabi’ini, Imami i famshëm. Ai e lexoi tefsirin para Ibn ‘Abbasit – dmth. Kur’anin - tre herë dhe e ndalonte atë për çdo ajet që nuk ia dinte kuptimin dhe e pyeste për kuptimin e tij. [Sherh Mukaddimeti fij Usuulit-Tefsiri, fq. 18-19, Shejkh Salih Ibn ‘Adul-‘Aziz Aali-Shejkh.]

⁸³ Ez-Zumer, 23.

rëndësi të madhe këtij lloj shpjegimi (tefsiri). Për këtë ka mjaft shembuj, e po të fillonim t'i përmendim do të zgjateshim me numërimin e tyre.

Pastaj, mbas Fjalës së Allahut vjen shpjegimi i Kur'anit me Sunet, ngase pas Allahut askush nuk është më i ditur për ato çfarë ka për qëllim Allahu (në Kur'an) sesa i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*), të cilit i zbriti Kur'ani dhe u urdhërua që t'ua sqarojë atë njerëzve.

Pastaj vijnë fjalët e Sahabëve, ngase ata jetuan në kohën kur shpallej Kur'ani dhe mësuuan direkt nga i Dërguari (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*).

Pastaj vijnë Imamët e Tabi'inëve.

Më pas shpjegimi merret nga thëniet e dijetarëve të Tefsirit, ato fjalë të cilat janë më afër Kur'anit, Suneti dhe thënieve të Sahabëve, ose përndryshe merret nga domethëniet gjuhësore të Arabishtes, ngase ajo është gjuha e Kur'anit.

Mes dijetarëve të Tefsirit ka që ndjekin rrugën e Ixhtihadit dhe nxjerrjes së dispozitave dhe dobive (nga Libri i Allahut); nëse folën saktë, atëherë do të marrin dy shpërblime, e nëse gabuan, atëherë do të marrin shpërblimin e ixhtihadit, nëse ishte rezultat i diturisë së tyre.

Dhe këtu duhet bërë një sqarim i rëndësishëm: se Muslimani duhet të ruhet që të mos flasë pa dije për Fjalët e Allahut, e të mos thotë: “Shpjegimi i këtij ajeti është kështu”, ndërkohë që ai nuk e di shpjegimin e atij ajeti. E me të vërtetë ky është një gjynah shumë i madh dhe është e folur për Allahun pa dije. Dhe Allahu e ka ndaluar këtë në Librin e Tij:

قُلْ إِنَّمَا حَرَّمَ رَبِّيَ الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطَنَ وَالْإِثْمَ وَالْبَغْيَ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَأَنْ تُشْرِكُوا

بِاللَّهِ مَا لَمْ يُنَزَّلْ بِهِ سُلْطَانًا وَأَنْ تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَعْمَلُونَ ﴿٧٨﴾

“Thuaj: Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pahijshme, qofshin të hapëta ose të fshehta dhe gjynahet, dhunimin pa të drejtë,

t'i shoqërohet Allahut (në adhurim) diçka për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini.”⁸⁴

Pastaj, [duhet të dimë se] mësimi i këtij Kur'ani dhe t'ua mësosh atë të tjerëve është farz kifaje (detyrë e kufizuar) për Umetin, në mënyrë që dituria e Kur'anit të mbetet në Umet. Dhe kush e merr përsipër këtë punë, ai është prej më të mirëve të këtij Umeti. Thotë Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*):

﴿ خَيْرُكُمْ مَنْ عِلْمَ الْقُرْآنِ وَعِلْمُهُ ﴾

“Më të mirët prej jush janë ata që e mësojnë Kur'anin dhe ua mësojnë të tjerëve.”⁸⁵ E ka transmetuar Bukhari nga 'Uthmani (*radij-Allahu 'anhu*).

Kurse në një transmetim tjetër:

﴿ خَيْرُكُمْ أَوْ أَفْضَلُكُمْ ﴾

“Më i miri prej jush ose më i virtytshmi prej jush...”⁸⁶

E shtata: Është obligim për atë që ka mësuar Kur'anin që të punojë me të, dhe puna është fruti i diturisë dhe është qëllimi i zbritjes së Librave dhe dërgimit të të Dërguarve. Përndryshe, dituria pa vepra nuk i bën dobi poseduesit të saj, përkundrazi, e dëmton atë.

Dhe është transmetuar nga 'Ali Ibn Ebij Talib (*radij-Allahu 'anhu*):

هتف العلم بالعمل ، فإن أجابه وإلا ارتحل

“Pasojeni diturinë me vepër, sepse nëse nuk i përgjigjeni diturisë, atëherë ajo do të ikë.”

⁸⁴ El-A'raf, 33.

⁸⁵ Sahih el-Bukhari (6/108).

⁸⁶ Sunen et-Tirmidhi (n.2908).

Dhe me të vërtetë Allahu na ka njoftuar për ndodhinë e atij që mësoi diçka rreth ajeteve të Allahut porse nuk punoi me to dhe e përngjasi atë me shembullin më të shëmtuar e më të keq. Thotë i Përsosuri nga çdo e metë:

وَأْتِلْ عَلَيْهِمْ نَبَأَ الَّذِي ءَاتَيْنَاهُ ءَايَاتِنَا فَانْسَلَخَ مِنْهَا فَاتَّبَعَهُ الشَّيْطَانُ فَكَانَ مِنَ الْغَاوِينَ
 وَلَوْ شِئْنَا لَرَفَعْنَاهُ بِهَا وَلَكِنَّهُ أَخْلَدَ إِلَى الْأَرْضِ وَاتَّبَعَ هَوَاهُ فَمَثَلُهُ كَمَثَلِ
 الْكَلْبِ إِنْ تَحْمِلَ عَلَيْهِ يَلْهَثْ أَوْ تَتْرُكْهُ يَلْهَثُ ذَٰلِكَ مَثَلُ الْقَوْمِ الَّذِينَ كَذَّبُوا
 بِءَايَاتِنَا فَاقْصُصِ الْقَصَصَ لَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ ﴿١٧٦﴾

“Tregoju atyre për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por ai u largua prej tyre. Kështu, Shejtani e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit. Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas epshit të tij. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, e nëse e braktis, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.”⁸⁷

Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë për Çifutët:

مَثَلُ الَّذِينَ حُمِّلُوا التَّوْرَةَ ثُمَّ لَمْ يَحْمِلُوهَا كَمَثَلِ الْحِمَارِ يَحْمِلُ أَسْفَارًا بِئْسَ مَثَلُ
 الْقَوْمِ الَّذِينَ كَذَّبُوا بِءَايَاتِ اللَّهِ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿١٧٧﴾

“Shembulli i atyre të cilëve iu besua Teurati, por pastaj nuk e zbatuan atë, i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat. Sa i keq është shembulli i popullit që mohon shpalljet e Allahut! Allahu nuk e udhëzon popullin zullumqar.”⁸⁸

⁸⁷ El-A'raf, 175-176.

⁸⁸ El-Xhumu'ah, 5.

Dhe Ai ka lavdëruar një grup njerëzish nga Ehlul-Kitabët, ngase ata punonin me Librin e tyre. Thotë Allahu:

الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَتْلُونَهُ حَقَّ تِلَاوَتِهِ أُولَٰئِكَ يُؤْمِنُونَ بِهِ ۖ وَمَنْ يَكْفُرْ بِهِ ۖ
فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ ﴿١٣١﴾

“Ata të cilëve u kemi dhënë Librin dhe e lexojnë ashtu siç është shpallur, ata besojnë vërtet në të. Kurse ata që nuk besojnë në të, pa dyshim, ata janë të humbur.”⁸⁹

Që do të thotë se ata e bënin hallall atë që ishte hallall dhe e bënin haram atë që ishte haram dhe nuk i ndryshonin kuptimet e Librit. Sikurse ka thënë Ibn 'Abbasi (*radij-Allahu 'anhuma*):

ومن لم يعمل بالقرآن من هذه الأمة فإن القرآن قد يكون حجة عليه

“Kush nga ky Umet nuk punon me këtë Kur'an, atëherë Kur'ani do të jetë argument kundër tij.”

Dhe na ka njoftuar Pejgamberi jonë Muhamed (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) për ibadetin e një populli, për namazin, agjërimin dhe këndimin e shumtë të kuranit, e megjithatë ata janë në gjendjen më të keqe.

Nga Ebu Se'ïjd el-Khudrij (*radij-Allahu 'anhu*) i cili ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) të thotë:

يُخْرِجُ فَيْكُم قَوْمٌ تَحْقِرُونَ صَلَاتَكُمْ مَعَ صَلَاتِهِمْ ، وَصِيَامَكُمْ مَعَ صِيَامِهِمْ ، وَعَمَلَكُمْ مَعَ عَمَلِهِمْ ، وَيَقْرَءُونَ الْقُرْآنَ لَا يَجَاوِزُ حَنَاجِرَهُمْ ،
يَمْرُقُونَ مِنَ الدِّينِ كَمَا يَمْرُقُ السَّهْمُ مِنَ الرَّمِيَةِ ، يَنْظُرُ فِي النَّصْلِ فَلَا يَرَى شَيْئًا ، وَيَنْظُرُ فِي الْقَدَحِ فَلَا يَرَى شَيْئًا ، وَيَنْظُرُ فِي الرِّيشِ فَلَا يَرَى شَيْئًا ، وَيَتَمَارَى فِي الْفَوْقِ ﴿١٣١﴾

⁸⁹ El-Bekareh, 121.

“Do të dalë nga një popull, para të cilëve ju do të nënçmoni namazin tuaj në krahësim me namazin e tyre, agjërimin tuaj në krahësim me agjërimin e tyre, veprat tuaja në krahësim me veprat e tyre. Ata e lexojnë Kur'anin dhe ai nuk i kalon gurmazet e tyre. Dalin nga Feja ashtu siç del shtiza përtej presë së saj; barkëtari shikon në kokën e shtizës dhe në të s'ka mbetur asnjë gjurmë nga preja, shikon në trupin e shtizës dhe në të s'ka mbetur asgjë gjurmë nga preja, shikon në pendët e shtizës dhe në të s'ka mbetur asnjë gjurmë nga preja. Pastaj kërkon mos gjen diçka më tej.”⁹⁰

Selefët e Devotshëm nga Sahabët (*radij-Allahu 'anhum*) dhe ata që erdhën pas tyre, kanë qenë shumë të zellshëm në punimin me ato që mësonin nga Kur'ani, më shumë se ç'mund t'i kushtonin rëndësi mësimi përmendësh të Kur'anin pa e vënë në punë atë.

Thotë Ebu 'Abdur-Rrahman es-Sulemij (*rahimehullah*): Na kanë transmetuar ata që na lexonin Kur'anin – siç ishte 'Uthman Ibn 'Affani dhe 'Abdullah Ibn Mes'udi (*radij-Allahu 'anhum*) se ata nëse mësonin dhjetë ajete nga Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*), nuk vazhdonin të mësonin më tej derisa të mësonin edhe diturinë dhe veprat që përmbanin ato dhjetë ajete. Ata kanë thënë: “Kështu e mësuam Kur'anin me diturinë dhe veprat së bashku.” Përcjellë nga Imam Ahmedi në Musnedin e tij.

Dhe në transmetimin e tij:

Nga Ebij 'Abdur-Rrahman i cili ka thënë: Na kanë transmetuar ata të cilët na e lexonin Kur'anin, prej Sahabëve të Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*), se ata mësonin dhjetë ajete nga i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe pastaj nuk fillonin dhjetë ajete të tjera derisa të mësonin diturinë dhe veprat që përmbajnë ato. Ata thonin: “Kështu mësuam diturinë dhe punën.”

Prandaj ata qëndronin për një farë kohe duke mësuar një sure të vetme. Thotë Enesi (*radij-Allahu 'anhu*):

كان الرجل إذا قرأ البقرة وآل عمران جل في أعيننا

⁹⁰ Sahih el-Bukhari (6/115), Sahih Muslim (n. 147, 1064).

“Nëse dikush mëson të suren el-Bekare dhe suren Aali-Imran, ai bëhej njeri i lartë para syve tanë.”

Dhe është transmetuar në Muwetta-n⁹¹ e Malikut se atij i treguan që ‘Abdullah Ibn ‘Umeri (*radij-Allahu ‘anhuma*) ndenji tetë vjet duke mësuar suren el-Bekare.

Dhe kështu pra, ne e shohim zellin e madh të atyre njerëzve fisnikë në meditimin mbi domethëniet e Kur'anit dhe punimin me të, e jo vetëm në mësimin përmendësh të fjalëve të tij.

E teta: Muslimanët duhet të ruhen nga braktisja e Kur'anit. Thotë Allahu i Lartësuar:

وَقَالَ الرَّسُولُ يَرْبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا هَذَا الْقُرْآنَ مَهْجُورًا

“Pastaj i Dërguari do të thotë: O Zoti im! Vërtet që populli im e braktisi këtë Kur'an.”⁹²

Dhe i ka përmendur Ibnul-Kajjim (*rahimehullah*) llojet e braktisjes së Kur'anit, prej të cilave:

E para: Braktisja e dëgjimit të Kur'anit, mosbesimi në të dhe injorimi i tij.

E dyta: Braktisja e të punuarit me të dhe mos-respektimi i hallallit dhe harramit në Kur'an, edhe nëqoftëse ai i pohon dhe i beson.

E treta: Braktisja e ligjeve të tij dhe gjykimin me të në bazat e Fesë, në degëzimet e Fesë; dhe të besosh se ai nuk është i sigurtë dhe se argumentet në fjalët e tij nuk janë dituri.

⁹¹ El-Muwetta (n.479), përcjellë nga Jahja Ibn Jahja el-Lejthi, përpiluar nga Ahmed Ratib ‘Armush, bot. Daar en-Nefa`is, Bejrut. Kjo është nga fjalët e Imam Malikut rahimehullah. Ka përmendur Sujuti në librin e tij “*Tenuir el-Hawalik*” (1/370) se Ibn Seadi e ka transmetuar atë në et-Tabakat duke e lidhur (zinxhirin e transmetimit) me ‘Abdullah Ibn Xha’fer, nga Ebil-Melijh, nga Mejmoni, se Ibn ‘Umeri e mësoi Bekarenë për tetë vjet.

⁹² El-Furkan, 30.

E katërta: Braktisja e meditimit, kuptimit dhe njohjes së qëllimeve të Atij që ka folur me ato fjalë (në Kur'an).

E pesta: Braktisja e shërimit dhe kurimit me Kur'an për të gjitha sëmundjes e zemrës dhe sëmundjet e tjera. Pra, në vend të tij kërkohet shërimi i sëmundjeve nga gjërat e tjera dhe braktiset kurimi me Kur'an.

Dhe të gjitha këto hyjnë tek thënia e Tij:

وَقَالَ الرَّسُولُ يَرْبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا هَذَا الْقُرْآنَ مَهْجُورًا ﴿٣٠﴾

“Pastaj i Dërguari do të thotë: O Zoti im! Vërtet që populli im e braktisi këtë Kur'an.”⁹³

Edhe pse disa forma të braktisjes janë më të vogla se të tjerat.” Mbaruan fjalët e Ibnul-Kajjimit (*rahimehullah*).⁹⁴



⁹³ El-Furkan, 30.

⁹⁴ El-Feua` id (fq.82), Mektebeh Rrijjad el-Hadijtheh, Imam Shemsud-Din Muhamed Ibn Ebij Bekr, i njohur ndryshe si Ibn Kajjim el-Xheuzijeh.



Ka disa norma dhe çështje të cilat lexuesi i Kur'anit duhet t'i vëjë në praktikë, të cilat janë:

Ë para: Gjendja e tij kur këndon apo reciton Librin e Allahut të jetë sa më e përsosur: i pastër, i rregullt dhe ta nderojë këtë Libër Fisnik. Pastrimi kur këndon Kur'an është i pëlqyeshëm, mirëpo s'ka problem nëse e këndon Kur'anin duke qenë i papastër (d.m.th. pa abdes), ngase Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) një herë u çua nga gjumi, lau fytyrën dhe filloi të këndonte dhjetë ajetet e fundit të sures Aali-Imran dhe nuk mori abdes.⁹⁵

Një herë 'Umer Ibnul-Khattab (*radij-Allahu 'anh*) ishte tek disa njerëz me të cilët po këndonte Kur'an. 'Umeri u çua dhe shkoi për të kryer nevojën e tij dhe pastaj u kthye dhe vazhdoi të këndonte Kur'an. Atëherë i tha njëri prej tyre: “O Prijësi i Besimtarëve, a po këndon Kur'an pa marrë abdes?” Dhe ia ktheu 'Umeri: “Kush ta paska dhënë këtë fetva? Musejlemeja⁹⁶?” E ka transmetuar Maliku në *Muwetta*-n e tij.⁹⁷

Ka thënë Ibn 'Abdul-Berr: “Ky hadith përmban lejueshmërinë e këndimit të Kur'anit kur je i pastër – jo duke lexuar në librin e Kur'anit – për atë që nuk është me abdes, për sa kohë që ai nuk është xhunub. Dhe tek kjo nuk

⁹⁵ Sahih Muslim, *et-Taharah* (n.256), Sunen en-Nesa'i, *Kijamul-Lejl ue Tetawu' en-Nehar* (n.1705), Sunen Ebij Davud, *es-Salatu* (n.1353), Musned Ahmed (1/275).

⁹⁶ **Shënim i përkthyesit:** Musejlemeh el-Kedhabi ishte një burrë që pretendoi se ishte profet dhe se i zbriste shpallje nga Allahu 'Azze ue Xhel, në kohën kur iDërguari i Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ishte ende gjallë. U vra në betejën e Jemames nga Uahshij Ibn Harb (*radij-Allahu 'anh*).

⁹⁷ Transmetuar nga Maliku në *Muwetta*-n e tij (n.470).

ka mospajtim tek xhemati i dijetarëve, me përjashtim të atij që kundërshtoi xhematin e tyre dhe polemizon me ta. Dhe të mjafton ty si shembull jeta e Xhematit të Sahabëve, dhe ata janë Selefët e Devotshëm (es-Selefus-Salih).”⁹⁸

Me të vërtetë, ixhmaja për lejueshmërinë e këndimit të Kur'anit nga ai që është i papastër është përcjellë nga Neveviu dhe Ibn Tejmija (*rahimehuma Allah*).⁹⁹

Kurse sa i përket atij që është xhunub, ai s’duhet të këndoje Kur'an derisa të marrë gusl, në sajë të hadithit të ‘Aliut (*radij-Allahu ‘anhu*) i cili ka thënë:

﴿ كان النبي -صلى الله عليه وسلم- لا يحجبه عن قراءة القرآن شيء إلا أن يكون جنباً ﴾

“Pejgamberin (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) nuk e pengonte asgjë nga këndimi i Kur'anit përveç se kur ishte xhunub.”¹⁰⁰

Dhe hadithet që flasin për këtë çështje përforcojnë njëra-tjetrën, dhe këtë e thonë shumica e dijetarëve të Fik’hut. Madje edhe Ibn ‘Abdul-Berr (*rahimehullah*) ka thënë: “Vërtet, Davudi (Ibn Hazm edh-Dhahirij) u veçua nga Xhemati duke e lejuar këndimin e Kur'anit për atë që është xhunub.”¹⁰¹

⁹⁸ “*El-Istidhkar el-Xhamië li-Medhahib Fukaha el-Emsar ue ‘Ulema` el-Ektar fijma tedammenehu el-Muwetta min Me’anij er-Rra` ji uel-Athaar ue Sherh dhalike kul-luh bil-Ijxhaz uel-Ikhtisar*” e Hafidh Ebij ‘Umer Jusuf Ibn ‘Abdullah Ibn Muhamed Ibn ‘Abdul-Berr en-Nemirij el-Endelusij; me recensim dhe verifikim të origjinlit nga ‘Abdul-Muëtij Emin Kal’axhij (8/14), bot. Dar Kutejbeh në Damask dhe Bejrut, Dar el-Ua’ij në Alepo dha Kajro.

⁹⁹ “*Sunen ed-Darakutnij*” e Imam ‘Ali Ibn ‘Umer ed-Darakutnij, me verifikim dhe renditje nga es-Sejid ‘Abdullah Hashim Jemanij el-Medenij; dhe bashkë me të “*et-Tealijk el-Mugnij ‘ala ed-Darakutnij*” e Shejkh Ebut-Tajjib Muhamed Shemsul-Hak el-‘Adhijm Abadij (1/199), Kapitulli: Ndalimi i atij që është xhunub dhe femrës me menstruacione nga këndimi i Kur'anit, n.1, bot. Dar el-Mehasin, Kajro.

¹⁰⁰ Shiko “*et-Tibjan fij Aadab Hameletil-Kur'an*” (fq. 58), të Imam Ebij Zekerija Jahja Ibn Sherefud-Diin en-Neueuij (*rahimehullah*), me verifikim të ‘Abdul-Kadir el-Arnaut (*rahimehullah*), bot. Dar el-Bejan, Damask.

¹⁰¹ *El-Istidhkar*, 8/15.

Kurse sa i përket gruas me menstruacione, mendimi më i saktë është se asaj i lejohet të këndojë Kur'an gjatë kohës kur është me menstruacione, ngase nuk ka ardhur asnjë hadith i saktë që të ndalojë gruan me menstruacione nga këndimi i Kur'anit. Ndërsa krahasimi i saj me xhunubin nuk është i saktë, ngaqë papastërtia e gruas me menstruacione zgjat zakonisht dhe është frikë mos ajo e harron Kur'anin, kurse papastërtia e xhunubit nuk zgjat dhe ai e heq papastërtinë nga vetja e tij kur të dojë duke marrë gusl.

Por sa i përket prekjes së mus`hafit (dmth. librit të Kur'anit), më e sakta është se ai nuk e prek atë, me përjashtim të atij që është i pastër nga papastërtia e madhe dhe papastërtia e vogël, në sajë të thënies së Allahut të Lartësuar:

لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ ﴿٧٩﴾

“Atë (Kuranin) e prekin vetëm të pastërtit.”¹⁰²

Dhe gjithashtu ka ardhur në librin e ‘Amru Ibn Hazmit: “Dhe askush nuk e prek Kur'anin përveç atij që është i pastër.”

Ka thënë Ibn ‘Abdul-Berr (*rahimehullah*): “Libri i ‘Amru Ibn Hazmit është mirëpritur nga Ulematë dhe ata kanë punuar me të, dhe ai është tek ata më i famshëm dhe më i qartë sesa zinxhiri i vetëm i transmetimit që s’ka shikëputje në të.” Pastaj tha: “Dhe fukahatë e vendeve të ndryshme dhe shokët e tyre të cilëve u ka mbërritur kjo fetva, kanë ixhma për sa i përket faktit se mus`hafi nuk preket përveç se nga ai që është i pastër.”¹⁰³

E dyta: Nëse ai do të fillojë të lexojë, është e pëlqyeshme që të kërkojë mbrojtje prej Shejtanit, ngase Allahu i Lartësuar ka thënë:

فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ ﴿٧٩﴾

¹⁰² El-Uaki’a, 79.

¹⁰³ El-Istidhkar, 8/10.

“Dhe kur të lexosh Kuranin, kërko mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar.”¹⁰⁴

Dhe fjalët që duhet të thotë janë: “*E’udhu bil-lahi minesh-shejtanir-rraxhiim.*”

Kurse disa prej Selefëve thonin: “*E’udhu bil-lahi es-Semi’il-‘Aliim minesh-shejtanir-rraxhiim.*”

Dhe të dyja ato janë të sakta.

☪ **treta:** Lexuesi duhet të thotë në fillim të çdo sureje “*Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim*”, me përjashtim të sures el-Bera`eh (dmth. sureja Teubeh). Sepse mendimi më i saktë është që besmeleja është ajet Kur’anor që bën ndarjen midis sureve. Sahabët (*radij-Allahu ‘anhum*) e kanë vërtetuar këtë në mus’haf duke e vendosur (Besmelenë) në fillim të çdo sureje, me përjashtim të sures el-Bera`eh (et-Teubeh).

☪ **katërta:** Lexuesi i Kur'anit duhet të jetë i rrjedhshëm në leximin e tij, të jetë melodioz dhe jo në mënyrë belbëzake. Thotë Allahu *Subhanehu ue Te’ala*:

وَقُرْءَانًا فَرَقْنَاهُ لِتَقْرَأَهُ عَلَى النَّاسِ عَلَى مُكْثٍ وَنَزَّلْنَاهُ تَنْزِيلًا ﴿١٦﴾

“Ky është një Kuran, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t’ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.”¹⁰⁵

Dhe ka ardhur në Sahihun e Bukharit nga Ibn ‘Abbasi (*radij-Allahu ‘anhum*) për thënien e Allahut të Lartësuar:

لَا تُحْرَكُ بِهِ لِسَانُكَ لِتَعْجَلَ بِهِ ﴿١٧﴾

¹⁰⁴ En-Nahl, 98.

¹⁰⁵ El-Isra`, 106.

“Mos nxito (o Muhamed) në leximin e Kuranit me gjuhën tënde!”¹⁰⁶

“I Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) kur i zbriste Xhibrili me shpallje lëvizte gjuhën dhe buzët dhe kjo iu bë shumë e rëndë. Dhe ato lëvizje tregonin se atij po i zbriste shpallja. Kështu, Allahu i zbriti ajetet në suren el-Kijameh:

لَا تُحْرِكْ بِهِ لِسَانَكَ لِتَعْجَلَ بِهِ ۚ إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُ وَقُرْآنَهُ ۚ
فَإِذَا قَرَأْنَاهُ فَاتَّبِعْ قُرْآنَهُ ۚ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا بَيَانَهُ ۚ

“Mos nxito (o Muhamed) në leximin e Kuranit me gjuhën tënde! Ne e kemi për detyrë t’i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë. Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij! Pastaj Neve na takon që ta shpjegojmë.”¹⁰⁷

Ai (Ibn ‘Abbasi) tha (në shpjegimin e këtyre ajeteve): “Neve na takon që ta shpjegojmë atë me gjuhën tënde.”

Dhe tha: “Pastaj kur i vinte Xhibrili heshte, dhe kur ikte, ai e lexonte atë ashtu siç i kishte premtuar Allahu.”¹⁰⁸

Ka ardhur gjithashtu në Sahihun e Bukharit se një burrë i tha Ibn Mes’udit (*radij-Allahu ‘anhu*): “Mbrëmë lexova të gjitha suret Mufassal.” Ai (Ibn Mes’udi) ia ktheu: “Kjo është shumë shpejtë. Ne e kemi dëgjuar leximin (e Pejgamberit) dhe i mbaj mend shumë mirë suret që lexonte Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*): tetëmbëdhjetë sure nga el-Mufassal dhe dy sure nga ato që fillojnë me Ha-Miim.”¹⁰⁹

¹⁰⁶ El-Kijameh, 16.

¹⁰⁷ El-Kijameh, 16-19.

¹⁰⁸ Sahih el-Bukhari (6/112).

¹⁰⁹ Sahih el-Bukhari, 6/111-112.

Dhe ka ardhur në disa transmetime të tjera se ai burri i lexoi suret Mufassal në një rekat të vetëm.¹¹⁰

Kurse në transmetimin e Ebi Davudit ka ardhur se ai recitoi suret me gjatësi të barabartë dhe ai (Ibn Mes'udi) tha: “Mirëpo Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) recitonte dy sure të barabarta në një rekat: en-Nexhm dhe er-Rrahman në një rekat, el-Kamer dhe el-Hakkah në një rekat, et-Tuur dhe edh-Dharijat në një rekat, el-Uaki'ah dhe el-Kalem në një rekat, el-Mearixh dhe en-Nazi'at në një rekat, el-Mutaffifiin dhe 'Abese në një rekat, el-Mudethir dhe el-Muzemmil në një rekat, ed-Dehr (el-Insan) dhe el-Kijameh në një rekat, 'Amme (en-Nebe'e) dhe el-Murselat në një rekat, dhe ed-Dukhan me et-Tekuir në një rekat.”¹¹¹

Dhe Suneti në recitim të Kur'anit është që të zgjaten disa tinguj. Dhe ka ardhur në një transmetim se Enesi (*radij-Allahu 'anhu*) u pyet për recitim të Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe tha: “Ai i zgjaste disa tinguj.”¹¹²

Kurse në një tekst tjetër të hadithit ka ardhur: “Pastaj ai (Enesi) recitoi: *Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim* dhe e zgjati zërin tek *Bismilahi*, e zgjati tek *er-Rrahmani* dhe e zgjati tek *er-Rrahim*.”¹¹³

☪ **pesta:** Është e pëlqyeshme që recituesi i Kur'anit ta zbukurojë zërin e tij me Librin e Allahut. Transmetohet nga Ebu Hurejrah (*radij-Allahu 'anhu*) i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ مَا أَدْنَىٰ لِّشَيْءٍ مَا أَدْنَىٰ لِلنَّبِيِّ أَنْ يَتَغَنَّىٰ بِالْقُرْآنِ ﴾

“*Allahu nuk dëgjon ndonjë gjë ashtu siç dëgjon një Pejgamber duke kënduar bukur Kur'anin.*”¹¹⁴

¹¹⁰ Sahih Muslim, n.822.

¹¹¹ Sunen Ebij Davud, n.1396.

¹¹² Sahih el-Bukhari (6/112).

¹¹³ Sahih el-Bukhari (6/112).

¹¹⁴ Sahih el-Bukhari (8/107-108).

Dhe në hadithin e Ebu Hurejrës i cili gjendet në Sahih ka ardhur po ashtu:

﴿ لَيْسَ مِنَّا مَنْ لَمْ يَتَغَنَّ بِالْقُرْآنِ ﴾

“Nuk është prej nesh ai që nuk e zëbukuron këndimin e Kur'anit.”¹¹⁵

Dhe është transmetuar në dy Sahihët nga hadithi i Ebu Musa el-Esh'arij (radij-Allahu 'anhû) se Pejgamberi (sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem) i tha atij:

﴿ يَا أَبَا مُوسَى ، لَقَدْ أُوتِيتَ مَزْمَارًا مِنْ مَزَامِيرِ آلِ دَاوُدَ ﴾

“O Eba Musa, ty të është dhënë fyell prej fyejve të Familjes së Davudit.”¹¹⁶

Ia tha këto fjalë kur dëgjoji zërin e tij të bukur duke kënduar Kur'anin.

☪ gjashta: Është e pëlqyshme të qash gjatë leximit të Kur'anit. Thotë Allahu duke lavdëruar ata të cilët e kanë këtë cilësi:

﴿ وَتُخْرَجُونَ لِلْأَذْقَانِ يَبْكُونَ وَيَزِيدُهُمْ خُشُوعًا ﴾

“Ata bien me fytyrë përtokë duke qarë dhe ai (leximi i Kuranit) ua shton përlujën.”¹¹⁷

Dhe Ai ka thënë për cilësinë e Pejgamberëve të Tij (‘alejhimus-selam):

﴿ إِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ آيَاتُ الرَّحْمَنِ خَرُّوا سُجَّدًا وَبُكِيًّا ﴾

¹¹⁵ Sahih el-Bukhari (6/209).

¹¹⁶ Sahih el-Bukhari (6/112) dhe teksti është i tij; Sahih Muslim (n.793).

¹¹⁷ El-Isra`, 109.

“Kur u lexoheshin vargjet e të Gjithëmëshirshmit, ata binin në sexhde dhe qanin.”¹¹⁸

Dhe ka ardhur në Sahih se i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) i tha Ibn Mes'udit (*radij-Allahu 'anhu*): “Më recito Kur'an.” Ai i tha: “Si të recitoj ty kur ai të është shpallur ty?” Ai tha: “Unë dëshiroj ta dëgjoj atë nga të tjerët.” Ibn Mes'udi tha: “Unë recitova suren Nisa` derisa arrita tek ajeti:

فَكَيْفَ إِذَا جِئْنَا مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ بِشَهِيدٍ وَجِئْنَا بِكَ عَلَى هَؤُلَاءِ شَهِيدًا ﴿٥١﴾

“Si do të jetë atëherë kur prej çdo populli të sjellim dëshmitarë dhe të të sjellim ty (o Muhamed) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!”¹¹⁹

Atëherë më tha, “*Mjaft*”, ose “*Mos vazhdo më*”. Dhe i pashë sytë e tij të mbushur me lotë.”¹²⁰

Dhe ka transmetuar Imam Ahmedi etj. nga Mutarrif Ibn 'Abdullah, e ai nga babai i tij i cili ka thënë:

رَأَيْتُ رَسُولَ اللَّهِ -صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ- يَصْلِي فِي صَدْرِهِ أَزِيْرَ
كَأَزِيْرِ الْمَرْجْلِ مِنَ الْبُكَاءِ

“E pashë të Dërguarin e Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) duke u falur dhe nga të qarët me dënësë kraharori i tij lëshonte një zë si kusia që vlon në zjarr.”¹²¹

¹¹⁸ Merjem, 58.

¹¹⁹ En-Nisa`, 41.

¹²⁰ Sahih el-Bukhari (6/114).

¹²¹ *Musned el-Imam Ahmed* (4/25,26); *Sunen Ebij Davud* (n.904); *el-Muxhteba* e Imam Ahmed Ibn Shu'ajb en-Nesa`i me verifikimin e Dr. 'Abdul-Fetah Ebu Guddeh, bot. Mekteb Metbu'at el-Islamijeh, Aleppo, (n.1214); *el-Kubra* e Imam Ahmed Ibn Shu'ajb en-Nesa`i me verifikimin e D. 'Abdul-Gaffar Sulejman el-Bendarij dhe Sejjid Kesrauij Hasen, (n. 544, 1135), bot. Daar el-Kutub el-'Ilmijeh, Bejrut; *Sahih Ibn Hibban* e Imam Muhamed Ibn Hibban Ibn Ahmed Ebu Hatim et-Temimij el-Bustij, me renditjen e Ibn Balabanit dhe verifikimin e Shu'ajb Arnautit (n.665, 753), bot. Mu`essesetur-Risaleh, Bejrut; *el-Mustedrak 'ala es-Sahihajn* e Imam Muhamed Ibn 'Abdullah el-Hakim en-Nijsaburi, me verifikimin e 'Abdul-Kadir 'Ataa (n.971), bot. Daar el-Kutub el-'Ilmejjeh, Bejrut; *es-Sunen el-*

Dhe ka ardhur në Sahihun e Bukharit se 'A'ishah i tha Pejgamberit (*sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem*) kur ai ishte i sëmurë dhe urdhëroi që Ebu Bekri t'u printe njerëzve në namaz:

﴿إنه رجل رقيق، إذا قام مقامك لم يستطيع أن يصلي بالناس﴾

“Ai është njeri i ndjeshëm. Nëse qëndron në vendin tënd ai s'falet dot me njerëzit.”¹²²

Kurse në një transmetim tjetër:

“Njerëzit nuk dëgjojnë dot nga të qarët.”¹²³

'Umeri (*radij-Allahu 'anh*) kur falej qante aq shumë saqë dëgjohej e qara e tij në safet e fundit.

Transmetohet nga Ebij Raxha` i cili ka thënë: “E pashë Ibn 'Abbasin dhe poshtë syve të tij një vijë e rreshkur nga lotët.”

Dhe për këtë arsye, en-Neueuij (*rahimehullab*) ka thënë për të qarët gjatë këndimit të Kur'anit: “Ajo është cilësi e atyre që e njohin Allahun, e atyre që kanë ndjenja dhe janë robër të mirë të Allahut.”¹²⁴

Duhet ditur se të qarët dhe vajtimi i lavdëruar është ai që buron si rrjedhojë e meditimit në Librin e Allahut, meditim i cili i jep zemrës frikë dhe brengosje. Dhe kjo tregon përsosmërinë në imanin e robit.

Thotë Allahu:

Kubra e Imam Ahmed Ibnul-Husejn el-Bejhakij, me verifikimin e Muhamed 'Abdul-Kadir 'Ataa (n.3173), bot. Mektebeh el-Baz, Mekkeh el-Mukarrameh; *Sahih Ibn Khuzejmeh* e Imam Muhamed Ibn Is'hak Ibn Khuzejmeh es-Sulemi en-Nijsaburij (n.900), bot. Mektebul-Islamij, Bejrut.

¹²² Sahih el-Bukhari (1/165).

¹²³ Sahih el-Bukhari (1/165).

¹²⁴ *Et-Tibjan fij Adab Hameletil-Kur'an* e Imam Neveviut (fq.68).

اللَّهُ نَزَلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُتَشَابِهًا مَثَانِي تَقْشَعُرُ مِنْهُ جُلُودُ الَّذِينَ تَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمْ وَقُلُوبُهُمْ إِلَى ذِكْرِ اللَّهِ

“Allahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kuranin), Libër, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre kur përmendet Allahu.”¹²⁵

Dhe le të ruhen Muslimanët se mos qajnë për t'u dukur, për të tërhequr vëmendjen e njerëzve apo për ndonjë nevojë personale (të kësaj dynjaje), sepse me të vërtetë kjo është prej rreziqeve më të mëdha dhe shtigje nëpërmjet të cilave shejtani hynë tek rob.

☪ **shtata:** Është e pëlqyeshme që recituesi i Kur'anit, jo gjatë recitimit që nuk është obligim, kur të arrijë tek ajetet e Mëshirës, t'i kërkojë Allahut prej mirësisë së Tij. Dhe kur të arrijë tek ajetet e Dënimit, t'i lutet Allahut ta ruajë nga Dënimi i Tij.

Transmetohet nga Hudhejfeja (*radij-Allahu 'anhu*) se ka thënë:

صليت مع النبي -صلى الله عليه وسلم- ذات ليلة ، فافتح البقرة ،
فقلت: يركع عند المائة ، ثم مضى ، فقلت : يصلي بها في ركعة ،
فمضى ، فقلت : يركع بها ، ثم افتتح النساء فقرأها ، ثم افتتح آل
عمران فقرأها ، يقرأ مترسلا ؛ إذا مر بآية فيها تسبيح سبح ، وإذا مر
بسؤال سأل ، وإذا مر بتعوذ تعوذ ..

“U fala me Pejgamberin (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) një natë dhe ai filloi me Bekarenë. Thashë me vete: Do të bjerë në ruku kur të mbarojë 100 ajete. Pastaj kaluan 100 ajete dhe atëherë thashë: Ai do ta falë rekatin duke recituar të gjithë Bekarenë. Pastaj kaloi edhe Bekareja dhe thashë me vete: Tani do bjeri në ruku. Kur, ai fillon me suren Nisa` dhe e recitoi të gjithë.

¹²⁵ Ez-Zumer, 23.

Pastaj filloi suren Aali-'Imran dhe e lexoi të gjithë. Recitonte ngadalë. Nëse arrinte tek ajetet ku ka madhërim e madhëronte Allahun, nëse arrinte tek ajetet ku ka lutje i lutej Allahut, e nëse arrinte në ajetet ku kërkohet mbrojtje i kërkonte mbrojtje Allahut...”¹²⁶

☪ **teta:** Muslimani duhet ta ruajë mbamendjen, mësimin përmendësh. E nëse harron diçka prej tij të mos thotë “E harrova”, por të thotë: “U bëra ta harroj” (nga neglizhenca, nga mos-përsëritja, nga shejtani) ose “Më doli nga mendja.” Thotë Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*):

﴿بِسْمِ اللَّهِ أَنْ يَقُولَ نَسِيتُ آيَةَ كَيْتَ وَكَيْتَ ، بَلْ هُوَ نُسِّيَ﴾

“Sa keq që ndonjëri prej jush të thotë: “E harrova këtë e këtë ajet”, por le të thotë “U bëra ta harroj”.”¹²⁷

Ai e ndaloj thënien “e harrova” sepse ajo thënie nënkupton neglizhim dhe moskujdes ndaj Kur'anit. Dhe parimi bazë është se Muslimani tregohet përherë i zellshëm me Librin e Zotit të tij.

☪ **nënta:** S'ka ndonjë gjë të keqe nëse recitohet Kur'ani duke ecur apo duke qenë mbi kafshën e udhëtimit apo automjet, apo duke qenë i shtrirë. Është transmetuar nga 'Abdullah Ibn Mugaffel (*radij-Allahu 'anh*) se ka thënë: “E kam parë Pejgamberin (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) duke recituar ndërsa ishte lart mbi devenë e tij dhe ajo ishte duke ecur, kurse ai recitonte suren el-Fet'h ose disa ajete prej saj me një zë të ëmbël e kumbues.”¹²⁸

Dhe ka ardhur në dy Sahihët nga 'A'ishah (*radij-Allahu 'anha*) se ajo ka thënë: “I Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) mbështetej në prëhërin tim kur unë isha me menstruacione dhe pastaj recitonte Kur'an.”¹²⁹

Është transmetuar gjithashtu nga 'A'ishah (*radij-Allahu 'anha*) se ajo recitonte nga Kur'ani duke qenë e shtrirë mbi krevat.

¹²⁶ Sahih Muslim (n.772).

¹²⁷ Sahih el-Bukhari (6/109), nga hadithi i 'Abdullah Ibn Mes'udit (*radij-Allahu 'anh*).

¹²⁸ Sahih el-Bukhari (6/112).

¹²⁹ Sahih el-Bukhari (1/77) dhe Sahih Muslim (n.301) dhe teksti është tek Muslimi.

Dhe është transmetuar nga Ebu Musa el-Esh'arij (*radij-Allahu 'anhu*) se ai ka thënë: “Unë e recitoj Kur'anin në namazin tim si dhe në shtratin tim.”

E dhjeta: Muslimanët e kanë detyrë që të jenë në harmoni me njëri-tjetrin për sa i përket recitimit të Kur'anit dhe të kenë kujdes nga zënkat dhe përçarjet. Ka ardhur në Sahihun e Bukharit se Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë:

﴿ اقرءوا القرآن ما ائتلف عليه قلوبكم ، فإذا اختلفتم فقوموا عنه ﴾

“Lexojeni Kur'anin për sa kohë që zemrat tuaja janë në harmoni (d.m.th. të bashkuara në domethëniet e tij), por nëse kundërshtoheni, atëherë çohuni dhe lëreni.”¹³⁰

Dhe kjo është me qëllim që të mos shkaktohen zënka dhe konflikt, derisa të arrijnë në përçarje.

¹³⁰ Sahih el-Bukhari (6/115) nga hadithi i Xhundub Ibn 'Abdullah.

Shënim i përkthyesit: Ka thënë el-Hafidh Ibn Haxher në *el-Fet'h*: “Thënia e tij: “Por nëse kundërshtoheni” – domethënë në kuptimin e domethënies së tij, “atëherë çohuni dhe lëreni” – domethënë shpërndahuni që të mos ju çojë mosmarrëveshja në sherr. Ka thënë 'Ijadi: “Mundet edhe që ndalimi të jetë specifik për kohën e tij (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), në mënyrë që ajo të mos bëhet sebeb për zbritjen e diçkaje (prej Shpalljes) që do t'i bëjë ata të ndihen keq, siç është në Thënien e të Lartësuarit: “Mos pyesni për gjëra, që, sikur t'ju thuheshin haptazi, do t'ju bënin keq.” [el-Ma`ideh, 101-102] Dhe mundet që kuptimi të jetë: Lexoni dhe mbajeni fort harmoninë me njëri-tjetrin karshi domethënies dhe konkluzioneve. Dhe nëse ndodh mosmarrëveshje ose dikush hedh ndonjë dyshim (*shubhe*) me të cilën kërkon grindje, që më pas shkakton përçarje, atëherë lëreni leximin; dhe kapuni fort mbas asaj që është e qartë (*el-Muhkem*), e cila sjell harmoninë, dhe lëreni atë që është e paqartë (*el-Muteshabih*), e cila ju shpie drejt përçarjes. Kjo është e njëjtë me thënien e tij (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*): “Dhe nëse i shikon ata që ndjekin ajetet e paqarta në të (Kur'an), atëherë ruhu nga ata.” Gjithashtu nënkupton se ai ndalon nga leximi nëse ndodh mospajtim në mënyrën e leximit (kira'atet e Kur'anit), dhe të shpërndahen kur të ndodhë mospajtim dhe të vazhdojë secili sipas mënyrës së tij të të lexuarit. Dhe siç u përmend edhe më parë, është transmetuar nga Ibn Mes'udi se midis tij dhe disa Sahabëve të tjerë ndodhi një mosmarrëveshje rreth mënyrës së leximit të Kur'anit. Atëherë, ata shkuan tek Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe ai tha: “Të gjithë keni vepruar mirë.” Dhe nga kjo kritikë e hollë del në pah urtësia e përmendjes së hadithit të Ibn Mes'udit i cili është pasues i hadithit të Xhundubit.”

☪ **njëmbëdhjeta:** Prej gjëra të cilave doemos duhet kushtuar vëmendje është sexhdeja e recitimit të Kur'anit. Dhe shumica e Dijetarëve janë të mendimit se ajo është e pëlqyeshme ngase ka ardhur urdhëri për ta bërë atë. Ata kanë thënë se ajo është *mustehab*, sepse 'Umer Ibnul-Khattab (*radij-Allahu 'anhu*) recitoi në mimber ditën e Xhuma suren en-Nahl derisa arriti tek ajeti i sexhdes; ai zbriti dhe bëri sexhde dhe bënë sexhde edhe njerëzit. Kur erdhi e Xhumaja tjetër ai recitoi sërish derisa arriti tek ajeti i sexhdes dhe tha:

☪ يا أيها الناس ، إنا نمر بالسجود ، فمن سجد فقد أصاب ومن لم يسجد فلا إثم عليه .

“O ju njerëz, me të vërtetë ne hasim ajetet e sexhdes, kush bën sexhde merr shpërblim dhe kush nuk bën sexhde nuk merr gjynah.”

Kështu, 'Umeri nuk bëri sexhde.¹³¹

Kjo sexhde bëhet nga recituesi dhe nga dëgjuesi.

Pastaj, prej çështjeve të ligjëruara është që poseduesi i Kur'anit të jetë në gjendjen më të përsosur dhe me cilësitë më fisnike, ta ngrejë lart veten e tij përmbi çdo gjë që ka ndaluar Kur'anit, duke nderuar kështu Librin e Allahut; si dhe të jetë i ruajtur nga fitimet e ulta të kësaj dynjaje, të jetë mospërfillës ndaj çështjeve të pavlera, i përvuilur me robërit e Allahut. Me një fjalë: të jetë morali i tij Kur'ani, siç ka qenë ky udhëzimi i Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), sikurse është transmetuar nga 'A'ishah (*radij-Allahu 'anha*).

Dhe prej thënieve të shumëkuptimta të cilat duhet t'i vëjë në praktikë poseduesi i Librit të Allahut është ajo që ka thënë 'Abdullah Ibn Mes'udi (*radij-Allahu 'anhu*):

☪ ينبغي لحامل القرآن أن يعرف بليله إذا الناس نائمون ، وبنهاره إذا الناس مفطرون ، وبحزنه إذا الناس يفرحون ، وببكاؤه إذا الناس يضحكون ، وبصمته إذا الناس يخوضون ، وبخشوعه إذا الناس يخالون .

¹³¹ Transmetuar nga Bukhari.

“Poseduesi i Kur'anit duhet të njihet nga netët¹³² e tij kur njerëzit flejnë, nga ditët e tij¹³³ kur njerëzit hanë, nga trishtimi¹³⁴ i tij kur njerëzit gëzojnë, nga të qarët e tij kur njerëzit qeshin, nga heshtja e tij kur njerëzit dëfrehen, dhe nga përulësia e tij kur njerëzit kapardisen.”

Poseduesi i Kur'anit duhet të ruajë zemrën e tij, gjuhën e tij dhe gjymtyrët e tij; duhet të besojë vetëm të vërtetën me argumentin e saj; nuk duhet të thotë asgjë përpos të vërtetës dhe mirësisë dhe të mos bëjë asgjë përveç mirësisë; të bëjë ç'është e mundur që të largojë të pavërtetën nga vetja e tij, nga besimi i tij, nga fjalët e tij apo nga veprat e tij, si dhe të parandalojë të keqen e tij dhe dëmin e tij nga njerëzit.

Pastaj, le ta dijë çdo Musliman se recitimi i Kur'anit ndonjëherë është obligim (*uaxhib*), siç është recitimi në namaz, ngase ai është obligim me *ixhma*. Porse dijetarët nuk janë pajtuar se a është obligim vetëm recitimi i Fatihasë apo mjaftojnë sure ose pjesë të tjera të Kur'anit në vend të saj. Dhe mendimi i saktë është i pari. [Dmth. obligim është vetëm recitimi i Fatihasë.]

Ndonjëherë recitimi është i pëlqyeshëm (*mustehab*) dhe kjo është kur kalon përtej pjesës së obliguar për t'u recituar në namaz. Po kështu është edhe recitimi i Kur'anit në kohët e tjera.

Ndonjëherë ai mund të jetë i urryer (*mekruh*); nëse Kur'ani recitohet me zë dhe i ngatërron të tjerët apo ata që falen ose i bezdis ata që flenë.

Dhe ndonjëherë mund të jetë i ndaluar (*haram*), si për shembull ai që reciton Kur'anin duke dashur të duket para njerëzve e të fitojë famë. Ose ai që e reciton Kur'anin në vendet e bidateve, pasi kjo është ndihmë dhe bashkëpunim në të kotë (*Batil*). Dhe disa prej Ulemave e kanë ndaluar

¹³² **Shënim i përkthyesit:** dmth. nga qëndrimi i gjatë në namazin e natës, ndërsa të tjerët janë në gjumë.

¹³³ **Shënim i përkthyesit:** dmth. nga agjërimi i vazhdueshëm vullnetar, ndërsa të tjerët hanë e pinë.

¹³⁴ **Shënim i përkthyesit:** dmth. nga frika dhe tmerri i asaj Dite, të cilat e shoqërojnë përherë, ndërsa të tjerët janë të shkujdesur.

zgjatjen e recitimit të Kur'anit, gjë që shkakton deformimin e fjalëve, dhe poashtu recitimin e Kur'anit me zë melodioz njësoj si melodia e këngëve, duke e ruajtur kështu Librin e Allahut dhe duke e mbajtur të pastër nga çdo deformim.

Përveç kësaj, prej bidateve është edhe ajo që ndodh nëpër funerale ku recitohet Kur'ani, si dhe nëpër ngushëllimet dhe tubimet e njerëzve; poashtu pagesa për recitimin e Kur'anit dhe dedikimi i recitimit për të vdekurit, si dhe dukuri të tjera që janë përhapur tek njerëzit për shkak të dijes së paktë dhe injorancës mbizotëruese, si dhe numrit shumë të vogël të atyre që i kritikojnë dhe u sqarojnë njerëzve Fenë e tyre. E me të vërtetë të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!

Dhe diçka që duhet ta kenë parasysh dhe ta mësojnë të gjithë Muslimanët në tërësi, individët dhe pushtetarët, është se Libri i Allahut ka zbritur që të punohet me të, që të gjykohet me të dhe të gjykojmë vetet tona me të, ngase ai është burimi ynë i ligjvënies dhe atij duhet t'i kthehemi për të gjykuar e për të punuar.

Kjo ishte ajo që ma bëri të lehtë Allahu ta shkruaja, e këto janë veçse disa fjalë të thjeshta, ngase e drejta që ka Libri i Allahut është shumë herë më e madhe dhe pozita e tij është shumë herë më e lartë se ç'mund ta përshkruajnë fjalët apo ç'mund ta përmbushin hakun e Tij ibadetet; porse këto janë porosi me të cilat doja t'i bëja dobi vetes sime dhe vëllezërve të mi Muslimanë.

Lus Allahun e Lartësuar e të Gjithëfuqishëm që me Mirësinë dhe Bujarinë e Tij të na japë sukses në Fenë e Tij, të na mësojë kuptimin e saktë të Kur'anit dhe ta bëjë Kur'anin Madhështor pranverë të zemrave tona, dritë të gjokseve tona dhe largues të brengave dhe pikëllimeve tona.

O Allah, na rikujto ato që i kemi harruar prej tij, na mëso ato që nuk i dijmë prej tij, na jep recitimin e Kur'anit natën dhe ditën ashtu siç kënaqësh Ti, na bëj prej atyre që punojnë me ligjet e tij dhe besojnë në ajetet e tij të paqarta.

O Allah, bëje atë argument në favorin tonë e jo kundër nesh, bëje atë dëshmues për ne, argument për ne dhe udhëzuesin tonë që të na shpjerë në Xhenetet e Tua, në Xhenetet e Lumturisë.

O Allah na ngri me të në grada të larta, na hiq me të gjynahet dhe punët e këqija dhe bëje atë ndërmjetësues për ne o Zoti i Gjithësisë.

Lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, mbi Familjen e tij dhe Shokët e tij, si dhe mbi të gjithë ata që ndoqën shtegun e tyre deri në Ditën e Gjykimit.



Përktheu: Alban Malaj

E Xhuma, 24 Sheual 1432 Hixhrij/23 Shtator 2011

'Auali, Mekkeh

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَى عَبْدِهِ الْكِتَابَ وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا ۖ
قَيِّمًا لِّيُنذِرَ بَأْسًا شَدِيدًا مِّنْ لَّدُنْهُ وَيُبَشِّرَ الْمُؤْمِنِينَ
الَّذِينَ يَعْمَلُونَ الصَّالِحَاتِ أَنَّ لَهُمْ أَجْرًا حَسَنًا ۖ

V

“Çdo lavd dhe falënderim i përket Allahut,
i Cili i shpalli robët të Vet një Libër të dëlirë nga çdo shtrembërim.
(Një libër) të drejtë, për të paralajmëruar nëpërmjet tij,
dënim të ashpër (për jobesimtarët)
dhe për t’u dhënë lajmin e mirë besimtarëve,
të cilët bëjnë vepra të mira,
se për ta do të ketë një shpërblim të bukur.”

[el-Kehf, 1-2]